

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6177
E shtunë, 28 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Pavarësia e Shqipërisë
dhe pasojat e Luftës
së Parë Ballkanike
1912-1913 | FAQE 10-11



Prof. Dr. Ibrahim GASHI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI | FAQE 4-5

GJYKATA SPECIALE NUK MUND TA NJOLLOSË LUFTËN E UÇK-së

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë se akuzat e Gjykatës Speciale vetëm në planin afatshkurtër mund të ndikojnë në imazhin e Kosovës dhe të luftës sonë çlirimtare. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se në planin afatgjatë nuk do të mund të njolloset lufta e drejtë e UÇK-së. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për problemet e aktakuzës ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së. Sipas Muratit, në aktakuzë vërehet një tendencë e pashembullt e shtrembërimit të fakteve se kush ka qenë agresori në Kosovë dhe kush ka qenë duke u mbrojtur. I pari i LB-së ka vlerësuar se është naivitet i madh që Gjykata Speciale të lidhet me procesin e dialogut me Serbinë



Gazeta
"Epoka e re"
të gjithë
shqiptarëve
ua uron
28 Nëntorin!

OPINION

A DO T'I SHPALLË GJYKATA
SPECIALE ZGJEDHJET E
PARAKOHSHME NË KOSOVË?!

F. 11

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE

EDHE 12 TË VDEKUR
DHE 764 RASTE TË REJA
ME COVID NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



VERA E KOSOVËS NË TRYEZAT
EVROPIANE F. 9

SPORT

SOT TAKOHEN
BESA - PRISHTINA,
NESËR GJILANI - DRITA F. 16

28 NËNTORI BASHKON SHQIPTARËT

FAQE 2



Komuna e Prishtinës ka vendosur në shumë sheshe flamuj kuq e zi, për nder të 28 nëntorit, Ditës së Flamurit të shqiptarëve. Pavarësisht, masave kundër Covid-19, të

premtën është parë numër i madh i qytetarëve duke shëtitur rrugëve të Prishtinës. Një mundësi e mirë ishte edhe për shitësit në rrugë që të shesin flamuj e zbukurime tjera me shqiponjën

dykrerëshe. Dita e Flamurit i bashkon, i prek, i gëzon dhe i mallëngjen të gjithë shqiptarët, kudo që të ndodhen të shpërndarë nëpër botë

FSK-ja SYNON TË JETË USHTRI MODERNE DHE ANËTARE E NATO-s

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

28 Nëntori bashkon shqiptarët



Komuna e Prishtinës ka vendosur në shumë sheshe flamuj kuq e zi, për nder të 28 nëntorit, Ditës së Flamurit të shqiptarëve. Pavarësisht, masave kundër Covid-19, të premten është parë numër i madh i qytetarëve duke shëtitur rrugëve të Prishtinës. Një mundësi e mirë ishte edhe për shitësit në rrugë që të shesin flamuj e zburime tjera me shqiptonjën dykrerëshe. Dita e Flamurit i bashkon, i prek, i gëzon dhe i mallëngjen të gjithë shqiptarët, kudo që të ndodhen të shpërndarë nëpër botë

PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER) - Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912 dhe krijimi i Qeverisë së Vlorës ishte një fitore e përbashkët e popullit shqiptar që kishte luftuar pandërprerë ndër shekuj kundër sunduesve të ndryshëm. Populli shqiptar më 28 nëntor

1912 arriti ta krijojë të drejtën e tij të pamohueshme, për të pasur liri të plotë dhe sovranitet politik në të gjitha trojet e veta etnike, si të gjithë kombet e civilizuar në mbarë hapësirën e botës.

28 nëntori që nga paslufta festohet edhe në Kosovë. Por kjo datë nuk simbolizon vetëm

pavarësinë e Shqipërisë. Që nga viti 1997 kjo datë ka hyrë edhe në historinë më të re të Kosovës.

Pikërisht më 28 nëntor të vitit 1997 në fshatin Llaushë të Skenderajt, në varrimin e mësuesit Halit Geci, i cili u vra nga forcat serbe, doli publikisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës

(UÇK). 28 nëntori, po ashtu, shënon edhe ditëlindjen e komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jashari.

Komuna e Prishtinës ka vendosur në shumë sheshe flamuj kuq e zi, për nder të 28 nëntorit, Ditës së Flamurit të shqiptarëve. Pavarësisht, masave kundër Covid-19, të

premtën është parë numër i madh i qytetarëve duke shëtitur rrugëve të Prishtinës. Një mundësi e mirë ishte edhe për shitësit në rrugë që të shesin flamuj e zburime tjera me shqiptonjën dykrerëshe.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, me rastin e festës së 28 Nëntorit, ka uruar shqiptarët në Kosovë, Shqipëri dhe kudo që ata jetojnë, me dëshirën që të kenë vullnetin e duhur që ta shfrytëzojnë lirinë për t'i zhvilluar shtetet tona dhe për ta ndërtuar të ardhmen e kombit së bashku. "Kjo datë e rëndësishme e historisë sonë moderne sjell në vëmendjen tonë gjithë ata burra dhe gra të kombit që luftuan për lirinë e shqiptarëve. Pra, 28 nëntori është data që na e kujton Gjergj Kastriotin, Ismail Qemalin dhe patriotët e tjerë nëpër kohë, e deri te dalja në skenë e luftëtarëve të lirisë për Kosovën si dhe ditëlindjen e komandantit Adem Jashari!", ka thënë Likaj në urim.

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, ka thënë se festa e 28 nëntorit i bashkon të gjithë shqiptarët. "Dita e Flamurit Kombëtar të shqiptarëve, flamuri që u shndërrua në simbol kombëtar që i bashkon, i prek, i gëzon dhe i mallëngjen të gjithë shqiptarët, kudo që të ndodhen të shpërndarë nëpër botë. Edhe pse nuk jemi bashkë, kjo nuk do të thotë se nuk frymojmë, mendojmë dhe punojmë bashkë për një të ardhme në të cilën të gjithë do të jemi qytetarë të një familjeje të madhe evropiane", ka thënë Xhaferi.

Dritan Abazoviq propozohet për zëvendëskryeministër të Malit të Zi

PODGORICË, 27 NËNTOR-Mandatari për formimin e Qeverisë së re të Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq, paraqiti propozimin përfundimtar të përbërjes së kabinetit qeveritar. Zëvendëskryeministër do të jetë Dritan Abazoviq, udhëheqësi i Aksionit të Reformës së Bashkuar (URA), dhe i koalicionit "E zeza në të bardhë". Ministre e Mbrojtjes është propozuar Olivera Injac, profesoreshë e çështjeve të sigurisë. Në pozitën e ministrit të Brendshëm, Sergej Sekuloviq, ndërsa për atë të punëve të Jashtme, Gjorgje Raduloviq. Millojko Spaiq është emëruar për ministër të Financave dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa në

qeverinë e re do të bashkohen katër resore: i arsimit, shkencës, kulturës dhe sporteve, për udhëheqjen e kësaj ministrie është emëruar, Vesna Bratiq. Sipas propozimit të Krivokapiqit, ministre e Shëndetësisë duhet të jetë Jelena Boroviniq Bojoviq, ministër i Zhvillimit Ekonomik Jakov Milatoviq, ministër i Investimeve Kapitale, Mladen Bojaniq, ministre e Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Media, Tamara Srzentiq.

Ministri i Ekologjisë, Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të jetë Ratko Mitrovic, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave Aleksandar Stijoviq dhe



Ministri i Drejtësisë dhe të Drejtave të Pakicave Vladimir Leposaviq.

Krivokapiq tha se negociatori kryesor me BE-në do të emërohet rreth datës 15 dhjetor.

Për përbërjen e re të qeverisë së Malit të Zi parlamenti do të votojë më 2 dhjetor. "Nëse për katër vjet arrijmë të realizojmë paktën 50 për qind të asaj që kemi planifikuar, ne do t'i afrohem mjaftueshëm një

cilësie ndryshe të jetesës", tha Krivokapiq në një konferencë për media, duke shtuar se kjo është një qeveri e ekspertëve dhe se gjëja më e rëndësishme tani është që ata të fillojnë punën.

Më 8 tetor, presidenti malazez Millo Gjukanoviq emëroi Krivokapiqin si mandatari për formimin e qeverisë, pasi opozita fitoi zgjedhjet e 30 gushtit.

Pas tri dekadash, Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e Gjukanoviqit, u largua nga pushteti dhe një shumicë e re në parlament tani përbehet nga tre koalicionet: "Për Ardhmërinë e Malit të Zi", "Paqja është kombi ynë" dhe koalicioni "E zeza në të bardhë".

Me ceremoni zyrtare është shënuar “Dita e Forcës”

FSK-ja synon të jetë ushtri moderne dhe anëtare e NATO-s

Liderët institucionalë të Kosovës kanë vlerësuar se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) do të transformohet në një ushtri moderne që do të mund të kontribuojë në paqen në rajon dhe botë. Në Ditën e FSK-së ata kanë bërë me dije se synimi i kësaj force është anëtarësimi në NATO. Sipas tyre, institucionet e Kosovës do ta mundësojnë zhvillimin dhe modernizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)



**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Ushtruesja e detyrës e presidentes, Vjosa Osmani, ka thënë se Ushtria e Kosovës është shndërruar në një ushtri model falë sakrificës së djemve dhe vajzave të vendit. Në ceremoninë e organizuar për nder të Ditës së FSK-së, Osmani ka thënë se FSK-ja është sinonim i shtetësisë. “Ne si vend

asnjëherë s’kemi pasur synime pushtuese, por vetëm mbrojtjen e atdheut. Ambicie mbesin integrimi në NATO dhe BE. Forca jonë është sinonim i shtetësisë”, ka deklaruar Osmani përmes një video-mesazhi.

Më tej, ajo ka thënë se pjesëtarët e kësaj force janë të përgatitur sipas standardeve më të larta dhe janë të gatshëm të marrin pjesë në operacione të paqes. “Ushtria e Kosovës është

ndërtuar në themelet e sakrificës sublimë. Është e zonja t’i dalë zot atdheut në çdo kohë. Sot ushtria e Kosovës është simbol i shërbimit. Qëllimi kryesor yni gjithmonë ka qenë mbrojtja e atdheut tonë. Të stërvitur me standardet më të larta të NATO-s. Oficerët dhe nënoficerët po shkollohen jashtë vendit. Në këtë ditë të veçantë nuk të mund të mos shprehim falënderim për aleatët tanë”, ka deklaruar Osmani.

Ndërsa kryeministri Avdullah Hoti ka theksuar se FSK-ja është emblema e identitetit të shtetësisë së Kosovës, është shenja dalluese e modernitetit dhe e së ardhmes euroatlantike të republikës sonë. Ai nënvizoi se qytetarët me të drejtë e vlerësojnë FSK-në si institucionin më të besueshëm në vend dhe nënvizoi se ky është rezultat i politikave të duhura të Ministrisë së Mbrojtjes, udhëheqjes së mirë të eporëve dhe punës dhe përkushtimit profesional të secilit pjesëtar të saj.

Kryeministri Hoti ka thënë se pjesëtarët e FSK-së e kanë dhënë me sukses provimin e tyre para qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës, duke

marrë pjesë aktive edhe në përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19.

Për rritjen dhe perfeksionimin e FSK-ë, kryeministri Hoti ka falënderuar edhe vendet mike, anëtare të NATO-s, kontributin e të cilave e ka vlerësuar maksimalisht. Hoti ka thënë se Ushtria e Republikës së Kosovës do të jetë anëtare e Aleancës Veriatlantike, do të zhvillohet e do të forcohet sipas standardeve dhe kriterëve të kësaj aleance, në mënyrë që edhe djemtë dhe vashat tona të jenë pjesë aktive e misionëve paqësorë kudo në botë.

Në këtë ceremoni ka folur edhe ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, i cili ka thënë se FSK-ja i ka përmbushur me sukses të gjitha objektivat vjetore. Ai ka vlerësuar se pjesëtarët e FSK-së kanë arritur rezultate konkrete në menaxhim të resurseve njerëzore, arsimit, mbështetjes logjistike, transparencës dhe llogaridhënies. “Pas nëntë vjetësh angazhimesh të mëdha për avancimin e FSK-së, arritëm ta legjitimojmë dhe kurorëzojmë forcën me mandat ushtarak. Krahe me aleatët tanë nisëm transformimin e Forcës. Sot, me

krenari, përkundër sfidave me pandemisë, FSK-ja ka arritur t’i përmbushë detyrat e saj. Ne do të vazhdojmë të kemi në fokus politikatat integruese e mosdiskriminuese. Në këtë ditë të veçantë shpreh falënderim për kontribut të ushtarakëve për angazhimin e tyre. Besojmë fuqishëm se partneriteti me vendet e NATO-s do të vazhdojë”, ka deklaruar Quni. Ai ka shtuar se do të vazhdohen politika integruese duke qenë të hapur për të gjitha komunitetet. “Jam plotësisht i vetëdijshëm se, përkundër të arriturave, mbetet ende për t’u bërë. Kam besim të plotë se të gjithë pjesëtarët e FSK-së do t’i vazhdojnë përpjekjet për t’i realizuar objektivat. Kam besim të plotë se FSK-ja do të vazhdojë të jetë model i suksesit për këtë gjeneratë dhe histori suksesi për gjeneratat e ardhshme”, ka thënë ministri Quni.

Në vitin 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për transformimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura. Është paraparë që procesi i transformimit në Ushtrinë e Kosovës të zgjasë dhjetë vjet. Ky vendim i parlamentit nuk u mirëprit nga zyrtarët e NATO-s.





FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI

GJYKATA SPECIALE NUK MUND TA NJOLLOSË LUFTËN E UÇK-së

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë se akuzat e Gjykatës Speciale vetëm në planin afatshkurtër mund të ndikojnë në imazhin e Kosovës dhe të luftës sonë çlirimtare. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se në planin afatgjatë nuk do të mund të njolloset lufta e drejtë e UÇK-së. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për problemet e aktakuzës ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së. Sipas Muratit, në aktakuzë vërehet një tendencë e pashembullt e shtrembërimit të fakteve se kush ka qenë agresori në Kosovë dhe kush ka qenë duke u mbrojtur. I pari i LB-së ka vlerësuar se është naivitet i madh që Gjykata Speciale të lidhet me procesin e dialogut me Serbinë

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 NËNTOR -

"Epoka e re": Z. Murati, tashmë e kemi parë aktakuzën e redaktuar të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Cili është vlerësimi juaj për këtë aktakuzë?

Murati: Në momentin e votimit

për ndryshimet kushtetuese dhe të Ligjit për Dhomat e Specializuara është ditur se do të vije ditë e ballafaqimit me prodhimin e tyre, pra me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit Special. Ndonëse ka një problem me çështjen e vazhdimin të mandatit, sepse amendamentet kushtetuese iu japin kohë pesë

vjet për ta përmbyllur misionin, ashtu siç kam qenë i bindur, Gjykata Kushtetuese e Dhomave të Specializuara ka bërë një interpretim krejt tjetër, sidomos të paragrafëve 13 dhe 14 të nenit 162 (amendamenti 24) dhe ua ka vazhduar mandatin Dhomave të Specializuara. Sidoqoftë kjo tashmë është një situatë e cila nuk lë shtigje të tjera përpos atë

që thashë, të ballafaqimit me gjykatën, rrjedhimisht proceset gjyqësore dhe pasojat e saj. Sa i përket aktakuzës, ajo ka disa probleme. E para, përpjetet të përcaktojë se ka pasur një grup të organizuar brenda UÇK-së, pra ajo që quhet "ndërmarrje e përbashkët kriminale" që ka pasur synim realizimin e krimeve kundër njerëzimit dhe të luftës, përfshirë tendencën e qëllim të për ushtrimin e një pushteti politik duke frikësuar të tjerët, qoftë kundërshtarët politikë ndër shqiptarë, qoftë pjesëtarët e pakicave që jetojnë në Kosovë. Dhe duke qenë se këta njerëz kanë qenë në krye të UÇK-së, rrjedhimisht i bie se edhe synimi i UÇK-së ka qenë në funksion të realizimit të objektivave të këtyre personave. Pastaj në funksion të arsytimit se ata përbëjnë një ndërmarrje të përbashkët kriminale të gjitha

krimet e supozuara të UÇK-së apo edhe ato që janë dënuar në gjykatat e Kosovës i mëvishen këtij grupi. Pra, ka një grumbullim të rasteve të trajtuara më parë në procese të ndryshme gjyqësore vetëm se tani ato vihen në funksion të arsytimit të faktit se ato janë kryer në mënyrë sistematike si produkt i një udhëheqjeje që ka pasur ato qëllime. Sigurisht aktakuzat janë goditje për të gjithë UÇK-në, jo vetëm për ata që janë arrestuar deri më sot. Megjithatë, mos të harrojmë se këtë mekanizëm gjyqësor të pashembullt në historinë e drejtësisë në botë, e cila është ndërtuar nga Kosova, por nuk i përgjigjet asaj, e ka krijuar Kuvendi i Kosovës. E vërtetë, e ka krijuar pas presioneve të mëdha por, megjithatë, është produkt i yni. Unë personalisht jam i lumtur se deputetët e LB-së



UÇK-ja dhe e cila me ndihmën e NATO-s solli lirinë e vendi. Tash nëse merret, ta zëmë, vetëm pjesa e aktakuzës, ku trajtohet konteksti politik dhe historik në të cilin ka filluar dhe është zhvilluar lufta, aty vërehet një tendencë e pashembullt e shtrembërimit të fakteve se kush ka qenë agresori në Kosovë dhe kush ka qenë duke e mbrojtur dhe duke u përpjekur për t'u çliruar. Deri më tani artikulli i studiueses Anna Di Lellios që merret me këtë pjesë të aktakuzës është i duhuri për ta demaskuar këtë pjesë të aktakuzës.

“Epoka e re”: Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për t'u dalë në ndihmë personave të akuzuar?

Murati: Unë tani në këtë fazë nuk mendoj se institucionet kanë shumë mundësi të ndihmojnë. Janë mekanizmat për t'i ndihmuar edhe financiarisht ata që akuzohen si dhe familjarët e tyre. Dhe besoj se me kërkesën e avokatëve institucionet tona mund të ndihmojnë në zbardhjen e rrethanave të caktuara që do të mund t'i ndihmonin të akuzuarit. Përtej kësaj, do të jetë vështirë një ndërhyrje më e madhe sepse konsiderohet si ndërhyrje në drejtësi. Lufta për të vërtetën tonë e të luftës sonë pastaj është një çështje tjetër e të cilën duhet ta zhvillojmë çdo ditë e në mënyrë sistematike e jo me fushata të përkohshme dhe emocione të çastit.

“Epoka e re”: Kjo gjykatë, a mund të sjell ndonjë pasojë për shtetin e Kosovës?

Murati: Atë që e thashë më herët: mund të ndikojë në imazhin tonë dhe të luftës sonë në planin afatshkurtër. Edhe në rrethe të caktuara që kanë punuar kundër pavarësisë së Kosovës do të forcohet diskursi kundër pavarësisë dhe të goditet ndihma që na ka dhënë NATO-ja dhe aleatët e tjerë që e kanë përkrahur pavarësinë e

vendit. Sigurisht Serbia, e cila së bashku me Rusinë qëndrojnë prapa këtij projekti përmes raportit të Dik Martit, do të përpiqet që maksimalisht të shfrytëzojë këtë situatë për ta goditur shtetin e Kosovës dhe themelet mbi të cilat është ndërtuar. Sidoqoftë, kjo është betejë politike dhe propagandistike në të cilën ne do të duhej të ishim më të përgatitur e më unikë për ta zhvilluar. Mbi të gjitha, kjo betejë fitohet duke e konsoliduar shtetin e Kosovës, duke mos u frikësuar në procesin e dialogut, por guximshëm të hyjmë me opsione për t'i zgjidhur problemet e mbetura me Serbinë dhe të forcohem e të faktorizohemi si Kosovë e si komb shqiptar.

“Epoka e re”: Në këto rrethana kemi pasur zëra që kanë kërkuar ndërprerjen e dialogut me Serbinë. Si duhet të veprohet me këtë proces?

Murati: Për mua është naivitet i madh të lidhet dialogu me këto procese gjyqësore. A nuk e kemi ditur ne se një ditë gjykata do ta fillojë punën? A nuk e kemi ditur ne se Serbia me punën e saj të pandalshme qëndron prapa saj? A nuk i kemi ditur ne tash e 20 vjet qëndrimet e Serbisë? Dialogu nuk duhet të lidhet me procese të tilla. Problemin që e kemi si shoqëri me dialogun është se asnjëherë nuk kemi qenë të bindur se dialogu është në dobinë tonë. Andaj edhe sillemi ndonjëherë si fëmijë të llastuar. Puna është se politikanët tanë në diskursin e tyre rreth dialogut me një nëntekst që kuptohet lehtë e çojnë mesazhin se ne nuk e duam dialogun, por e bëjmë për shkak të aleatëve tanë. Andaj edhe ne pastaj nuk dimë se çfarë duam nga dialogu, nuk kemi një platformë të përpunuar politike dhe vetëm vazhdon mashtrimi i opinionit se po shkojmë në dialog për njohje. Lëvizja për Bashkim që

nga viti 2010 e ka pasur të qartë se dialogu me Serbinë, por jo ai teknik, por dialogu politik është e vetmja mënyrë për t'i zgjidhur problemet që kanë mbetur në mes të Kosovës dhe Serbisë. Dhe ne atëherë e sot jemi të bindur se nuk ka zgjidhje tjetër të konfliktit shqiptaro-serb, përkatësisht atij të Kosovës dhe të Serbisë, përveç idesë së ripërcaktimit të kufijve, që do të rezultonte me ndryshime kushtetuese në Kosovë, heqjen e privilegjeve kushtetuese për komunitetin serb, shndërrimin e Kosovës në një shtet të plotë sovran dhe hapjen e rrugës edhe për bashkim në mes të Kosovës dhe Shqipërisë nëse qytetarët e dy vendeve e duan atë.

“Epoka e re”: Gjithashtu, janë kërkuar edhe zgjedhjet e reja. Do të ishte më mirë të shkohohej në zgjedhje, apo të provohet zgjerimi i koalicionit qeverisës për t'u përballur me këto procese?

Murati: Situata politike në vend është pak të thuhet se është e çuditshme. Qeveria nuk i ka numrat për t'i kaluar ligjet më të rëndësishme, tani atë të rimëkëmbjes ekonomike dhe të buxhetit. Opozita nuk i ka numrat për ta rrëzuar qeverinë. Nuk ka qartësi në qëndrimet rreth presidentit, mundësisë së përfshirjes së PDK-së në qeveri dhe qëndrimet përfundimtar të AAK-së rreth presidentit. Në këto rrethana nuk ka shumë opsione. Njëra është marrëveshja për presidentin pa zgjerim të qeverisë. E dyta është marrëveshje për presidentin dhe zgjerimi i qeverisë. E treta është shkuarja në zgjedhje. E kam përshtypjen se çdoherë e më shumë po i afrohem të tretës. Ndonëse duket pak problematike dhe papërgjegjësi politike e aktorëve politikë që të çojnë vendin në zgjedhje në kohë pandemie, e kam përshtypjen se varianti më i mirë edhe për vendin edhe për funksionimin e institucioneve do të ishin zgjedhjet e reja.

kanë votuar kundër, ndonëse në planin e përgjithshëm ky tani është vetëm një satisfaksion moral e politik, por jo që ka ndonjë vlerë praktike.

“Epoka e re”: Aktakuzën ndaj tyre shumëkush e ka cilësuar si tendencë për ta kriminalizuar luftën e UÇK-së. A po tentohet ndryshimi i historisë përmes kësaj gjykate?

Murati: Nuk ka dyshim se në planin afatshkurtër këto

aktakuza, proceset gjyqësore dhe ndonjë aktgjykim mund të ketë efekt negativ për luftën tonë qoftë në planin ndërkombëtar, qoftë edhe në atë të brendshëm. Sidoqoftë, kam besimin e plotë që në planin afatgjatë lufta jonë është e pamundur të njolloset dhe të goditet. Është e pamundur të njolloset përpjekja e një populli për liri e cila në periudhën 1998-'99 u sublimua në luftën çlirimtare të udhëhequr nga

Të dielën mbahen zgjedhjet në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER)- Nesër (e diel) mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut. Në Komunën e Podujevës janë 45 Qendra të Votimit me gjithsej 115 Vendvotime, ndërsa në Komunën e Mitrovicës së Veriut janë 7 Qendra të Votimit me gjithsej 27 Vendvotime, të cilat do të hapen në ditën e zgjedhjeve më 29 nëntor. Në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të

Komunës së Podujevës janë tre kandidatë: Naim Fetahu (PDK) me numër 10; Nexhmi Rudari (LDK) me numër 11; dhe Shpejtim Bulliqi (LV) me numër 13. Ndërkaq në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Mitrovicës së Veriut janë në garë katër kandidatë: Erden Atiq (LV) me numër 121; Dusan Milunović (Kandidat i pavarur) me numër 122; Milan Radojeviq (Lista Serbe) me numër 123; dhe Florent Azemi (PDK) me numër 124.



A do t'i shpallë Gjykata Speciale zgjedhjet e parakohshme në Kosovë?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kujt po i kruhet, kujt po i kruhet: Midis partnerëve të koalicionit qeverisës duket se më nuk ka dashuri, madje as dashuri të interesit që, sidomos në vitet e fundit, është bërë vulë e patriotizmit. Pra, interesi material është bërë flamur mbi interesin kombëtar dhe shtetëror. Çështja e të bërit koalicion në Kosovë as më parë nuk ishte ngritur mbi parime që vlejshëm për shtetet demokratike, prandaj edhe qeverisja ishte nën çdo parim apo qeverisje e ngritur mbi bazën e interesit material, partiak, grupor dhe nepotist. Nëse sot e bëni një lexim të emrave që kanë bartur poste institucionale, atëherë aspak nuk duhet të habitemi për gjendjen në të cilën jemi. Madje punët i kemi shumë më mirë krahasuar me përkushtimin dhe profesionalizmin që na ka munguar, sidomos aty ku kërkohej. Është interesant fakti se sa ishim në vuajtje të dënimit në llogoret e ish-Jugosllavisë, asnjëherë nuk kemi diskutuar se duhet ta marrim pushtetin, t'i ndajmë postet apo jaranizmin ta bëjmë kriter të vetëm për punësim apo angazhim politik ndonëse disa prej nesh, pasi na e dhanë mundësinë, u treguam më grykës se vetë ata që kishin genë në pushtet në kohën e ish-Jugosllavisë. Kjo ka ndikuar që asnjëherë nuk kemi arritur ta ndërtojmë një kurriz politik të mbështetur në dije, profesionalizëm dhe parime. Për më keq, i kemi eliminuar apo vendosur në margjina ata që tërë jetën e sakrifkuan për liri, çlirim, çështje dhe bashkim kombëtar si rasti i Bacës Adem Demaçi apo edhe i komandantit legjendar Adem Jashari, i cili as për së afërmi nuk vlerësohet për sakrificën e bërë. Prandaj nuk mund të mbillni hitha e të korrni trëndafila. Një trëndafil e ka Kosova, Ekaterina Trëndafilova, kryetare e Gjykatës Speciale Njëetnike, Politike, dhe Raciste të Bangladeshit (Kosovës). Uroj që

këtë shkrim të mos e lexojë ambasadori i kategorisë super të rëndë se, më mori lumi. Ishin pritje të mëdha për koalicionin LV-LDK, madje edhe unë pata përkrahur këtë koalicion. Thuaja se 50 për qind e deputetëve të Kosovës ishin shqiptarë dhe për herë të parë vendimarrja nuk kushtëzohej nga Lista Serbe, ndërkaq që opozita premtoi se çdo marrëveshje apo ligj që është në dobi të Kosovës, do ta votojë. Kur doni të bëheni me shtëpi vlen një rregull; shtëpinë e parë e shitni, kurse të dytën e mbani për vete. Edhe Albin Kurti dhe LV-ja besnikërisht iu përmbajtën këtij rregulli, qeverisjen e parë e abortuan me vetëdëshirë kurse tani me çdo kusht duan zgjedhje të reja, me shpresë se do të qeverisin, madje edhe pa të tjerët sepse, sipas sondazheve, ata do t'i kenë së paku 55 deputetë e që është vështirë për të besuar! Po qejfi është më i madh se Stambolli! Një ditë para zgjedhjeve të fundit, 100 për qind kam parashikuar renditjen e subjekteve politike dhe se shkrimin e pata përfunduar se: "Fituesi i këtyre zgjedhjeve do të jetë humbësi më i madh...". Doli pikërisht ashtu! Po të sillej LV-ja më mirë me LDK-në, sot do të qeverisnin bashkë, Albini do të ishte kryeministër dhe, pa asnjë dyshim më shumë se 50 për qind e anëtarësisë së LDK-së do të ishin në anën e Vjosa Osmanit. Me një sjellje joracionale, imponuese dhe diktatoriale, LV-ja dhe Albini e rrënuan koalicionin duke e lënë Vjosa Osmanin thuaja pa krahë apo me vetëm një krah, Haxhi Avdylin. Ndërkaq dihet se me një krah nuk mund të fluturohet! LV-ja dhe LDK-ja me një mirëkuptim dhe respektim do të bënin punë të mira aq më parë që opozita kërcënohej me kryqëzim nga Juda i drejtësisë apo, siç e kanë karikatizuar Gjykatës Speciale, kryeprokurori Jack Smith. Pata shkruar, gjithashtu, se në asnjë rrethanë, në kohë të pandemisë dhe me një arsytim lëvyrës (prishjes së miqësisë me Grenellin dhe Trumpin), nuk do ta kisha votuar mocionin për rrëzim të qeverisë Kurti. PDK-ja e ka pasur një mundësi të jashtëzakonshme të profilizohet si parti opozitare dhe të reformohet në baza të shëndosha nëse nuk do ta

votonte mocionin për rrëzim të qeverisë Kurti. Nuk e bëri dhe gaboi!

Gjykata e Dick Martit e jo KQZ-ja, Ekaterina Trandafilova e jo Valdete Daka mund të organizojnë zgjedhje të jashtëzakonshme në Kosovë: Gjykata Speciale Njëetnike, politike dhe Raciste e nisi kryqëzimin e UÇK-së duke gozhdur, për fillim ish-krerët politikë, ushtarakë dhe policorë, për të bërë gati kryqë të tjera edhe për së paku 300 të tjerë (deri më tani) që do të gozhdohen fizikisht (të paraburgosur dhe të dënuar) dhe moralisht (duke i kushtëzuar të bëhen dëshmitarë, të mbrojtur e të cilët del se janë krejtësisht të pambrojtur). Të gjithë këta do ta kalojnë, fizikisht të gozhdur apo moralisht të gozhdur, Via Dolorosa (Rrugën e Dhimbjeve), nga Beogradi, deri në Hagë. Gjykata po imponon zgjedhje të reja dhe po del të jetë votuesja kryesore në Kosovë. Kujt po i kruhet më së shumti për zgjedhje përveç Ekaterian Trandafiloves?

LV-së dhe Albin Kurtit: LV-ja dhe Albin Kurti, që nga çasti kur morën në thua në Kuvendin e Kosovës me ndërskëmcat e LDK-së, PDK-së, AAK-së, Nismës, Pakicave dhe Grenellit asnjëherë më nuk e kanë dëgjuar Bob Marlin, por të vetmen këngë e kanë pasur: "duam zgjedhje...". Kanë të drejtë për faktin se i fitojnë, pa asnjë problem zgjedhjet, por nëse ata i fitojnë 55 deputetë, edhe unë do të shkoj të jetoj në Katmandu, kryeqytet i Nepalit dhe të bëhem mbret për faktin se atje po ka shumë probleme. Pra, në këtë rast, Albini mbret në Kosovë, Behxheti mbret në Nepal! Nëse LV-ja nuk arrin një marrëveshje parazgjedhore, vuajtjet e saj do të bëhen të padurueshme pas zgjedhjeve; i fiton zgjedhjet dhe nuk gjenë partnerë për qeverisje! Nëse shkohet në zgjedhje sipas kalendarit të Dick Martit dhe Ekaterina Karanfiloves, mund ta kemi një përafrim midis LV-së dhe AAK-së ku të gjithë do t'i arrinin synimet; Albini, kryeministër, Ramushi, president dhe neoshqiptari Pacolli, zot i diplomacisë apo kryetar Kuvendi. Sipas vendit, bëhet edhe Kuvendi!

LDK-ja: Nuk është aspak e

interesuar të shkojë në zgjedhje sepse vlerëson se nuk do të ndahet mirë, prandaj preferon gjendjen: "më mirë një zogëz e pemëve të glasitura në Prishtinë në duar, se një elefant në Parkun Kaldahari të Afrikës. Gjykata Speciale nuk paraqet rrezik fare për LDK-në e që nuk mund të thuhet e njëjta gjë për Gjykatën Komerciale. Për LDK-në është shumë e pranueshme mbajtja e pushtetit përmes përfshirjes së PDK-së në qeveri, së bashku me koalicionin aktual e që do t'i siguronte mandatin e plotë dhe lënien e LV-së në opozitë për aq kohë dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme do t'i pranonte aq sa një i sëmurë rëndë nga sytë, të kurohej me krip deti duke ia hudhur në sy!

PDK-ja: Është dëmtuar dhe dridhur deri në themel nga Gjykata e Dick Martit e që kjo dridhje tektonike - politike do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Përveç se i janë dridhur themelet, me marrjen e udhëheqësve të kësaj partie, PDK-ja, si shtëpi politike ka mbetur edhe pa kulm - kokë: Është deklaruar si opozitë, por se asnjëherë nuk kemi bindur se vërtet është opozitë! Në vend të një zëri, kemi pasur kakofoni deklarimesh dhe vendimesh. Është një disponim i shprehur botërisht se bëhet pjesë e qeverisë Hoti nëse si kundërvlerë e marrin postin e presidentit apo kryeministrit. Për kryeministër, Zoti i lashtë shëndoshë, nuk e lëshon Dulla mësa e ka lëshuar Zhuj Selmani kullën e Sheremetit, pa u bërë kiameti! Në momentin kur hyni në kombinime për poste të caktuara, askush nuk beson se jeni opozitë e vendosur dhe se doni të jeni opozitë! PDK-ja duhet të jetë e prerë në deklarime dhe qëndrime; nëse është e vendosur të mbetet në opozitë atëherë nuk duhet të diskutojë asnjë post, si biletë hyrëse për qeveri. Nëse mendon se duhet të jetë pjesë e qeverisë atëherë posti i presidentit nuk i duhet asgjë sepse secili nga PDK-ja, nëse do të bëhej president, nuk do të ishte as karikaturë e Hashim Thaçit e lëre më president funksional!

AAK-ja: Edhe kjo parti mund të preket nga koronavirusi i Gjykatës Speciale, por jo në atë masë sa PDK-ja. Nuk besoj se

AAK-ja ka rënë në dalli elektorale përveç, nëse nuk ka apo nuk e bën një marrëveshje parazgjedhore me LV-në dhe Albin Kurtin, me të cilën i garantohet një lundrim afatgjatë në pushtet. Në këtë rast, Ramushi mund të bëhet president sikur edhe nëse PDK-ja heq dorë nga posti i presidentit. AAK-ja ua ka zënë ngushtë të gjitha partive politike sidomos kur duhet të sigurohet prania e 80 deputetëve në sallën e Kuvendit për ta zgjedhur presidentin. AAK-ja e dëshmon më së miri se mes i artë është më i miri dhe më i sigurti nëse përdoret në kohë të duhur, në masë të duhur, në vend të duhur dhe në mënyrë të duhur. Edhe ashtu gjërat më të mira janë në mes dhe çdo gjë sillet kah mes; kërthiza është në mes, bota sillet rreth boshtit në mes dhe Mesi është futbollisti më i mirë i të gjitha kohëve!

Një çështje që më brengos shumë është se vendimarrja për shqiptarët dhe Kosovën, në vend se të jetë në Prishtinë apo Tiranë, tash është zhvendosur në Beograd dhe Hagë. Zhvillimet e fundit në Kosovë janë dëshmia më bindëse për këtë! Do të jetë edhe më bindëse edhe në të ardhmen, deri në shpërthimin e radhës.

Për mua nuk është aspak me rëndësi se kush fiton në zgjedhje eventuale sa është me rëndësi se kemi mbetur pa opozitë të vërtetë, pa ofertë serioze për qeverisje të mirë për faktin se thuaja të njëjtët politikanë na sillen e pështillen në Kosovë në 20 vjetet e fundit duke kënduar të njëjtën këngë: "vaj në çfarë derexhe ka rënë shteti, kur nga ne vjen pushteti..."

P.s. Të gjithë atyre që mendojnë shqip, veprojnë shqip e që e kanë dhënë edhe një kontribut të vogël për njerëzimin dhe shqiptarinë, të udhëhequr nga vullneti kuq e zi, ua uroj Festën e të gjithë shqiptarëve, Festën e Flamurit, 28 Nëntorin e Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës. Luigj Gurakuqit, Isa Boletinit, Bacës Adem Demaçi, Komandantit Legjendar Adem Jashari, heronjve dhe martirëve anekënd ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët.

Gëzuar, për ditë më të mira se këto të sotmet!

Edhe 12 të vdekur dhe 764 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 NËNTOR- Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1 827 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 764 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 12 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Podujevë dy raste (76, 66 vjeç), Prishtinë dy raste (74, 64 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (61 vjeç), Gjakovë një rast (85

vjeç), Gjilan një rast (79 vjeç), Kamenicë një rast (86 vjeç), Klinë një rast (59 vjeç), Lipjan një rast (76 vjeç), Prizren një rast (73 vjeç) dhe Rahovec një rast (46 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 37 792 raste nga 139 699 persona të dyshimtë me ketë virus dhe 975 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 584 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 23 274 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 543.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 319 raste, Gjilan 60 raste, Fushë-Kosovë 46 raste, Prizren 40 raste, Gjakovë 36 raste, Ferizaj 32 raste, Drenas 30 raste, Lipjan 28 raste, Pejë 28 raste, Viti 25 raste, Podujevë 24 raste, Kamenicë 14 raste,



Suharekë 14 raste, Obiliq 13 raste, Rahovec 12 raste, Klinë 9 raste, Istog 8 raste, Vushtrri 6 raste, Malishevë 5 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Hani i Elezit dhe Mitrovicë.

Mandati i Gjykatës Speciale zgjat deri në njoftimin e Këshillit të BE-së



PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER)- Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në Hagë vendosi se amendamentet kushtetuese të propozuara mbi vazhdimin e mandatit të

Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë nga ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara

me Kapitullin II të Kushtetutës.

Në komunikatën e Dhomave të Specializuara thuhet se "mandati i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së

Prokurorit të Specializuar ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri sa Këshilli i Bashkimit Evropian të njoftojë për përfundimin e mandatit të tyre". Më 25 gusht, ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me propozim për amendamentin e Kushtetutës për zgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Thaçi në propozimin e tij dërguar Kryesisë së Kuvendit, ka kërkuar të ndryshohet neni i amendamentit, ku thuhet se mandati i këtij institucioni do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare.

Sipas propozimit të Thaçit, mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së

Prokurorit të Specializuar "do të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës". "Duke qenë se amendamentet kushtetuese të propozuara sugjerojnë fshirjen nga neni 162(13) dhe (14) i Kushtetutës, të referencës ndaj Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014, Dhoma thekson se referenca në fjalë saktëson se mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së vazhdon deri në përfundimin e proceseve gjyqësore përkatëse. Rrjedhimisht, fshirja e kësaj reference do të pakësojë të drejtat dhe liritë themelore të personave të përfshirë në procese gjyqësore", thuhet në aktgjykim.

Hoti kërkon marrëveshje për presidentin ose zgjedhje

PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka mohuar të premten lajmin se ai do të japë dorëheqje nga posti i kryeministrit, pas raportimit në disa medie se e ka paraqitur dorëheqjen.

"Informacionet të cilat po qarkullojnë nëpër media për dorëheqjen e kryeministrit janë të pavërteta", është thënë në reagimin e qeverisë.

Kryeministri Hoti ka thënë se partitë parlamentare i kanë dy opsione: të gjejnë zgjidhje për çështjen e presidentit ose të dakordohen për datën e

zgjedhjeve. "Kryeministri Hoti ka dëshmuar gatishmëri e përkushtim për të ofruar zgjidhje për të gjitha çështjet e ngritura, duke zhbllokuar madje edhe proceset komplekse nëpër të cilat ka kaluar vendi siç ishte vendimi për vazhdimin e dialogut me parime, arritja e marrëveshjes së 4 shtatorit në Uashington, hartimi i pakos emergjente dhe asaj për rimëkëmbje ekonomike dhe masat konkrete në menaxhimin e pandemisë Covid-19", thuhet në reagimin e Qeverisë së Kosovës.



Vera e Kosovës në tryezat evropiane

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

SUHAREKË, 27 NËNTOR-Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, në kuadër të Javës së Biznesit Kosovar 2020, të premten ka vizituar verarinë "Agro Kosova Holding" në Suharekë. Me këtë rast kryeministri Hoti përgëzoi pronarin Aziz Tafa, për këtë investim, për ndërtimin e një biznesi model. "Prodhimet e Verarisë Suhareka 70-80 për qind e prodhimit del jashtë Kosovës me shënimin 'Made in Kosova' kjo është e rëndësishme", ka thënë kryeministri Hoti.

Ai nënvizoi ndihmën që qeveria i ka dhënë bizneseve për të përballuar krizën e shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Me këtë rast tha se deri më tani janë ndarë 270 milionë euro, përfshirë këtu edhe 60 milionë euro të shpërndara më herët. Prej tyre 24 milionë euro në bujqësi, duke dyfishuar subvencionimet për hektarë të vreshtave nga një mijë, në dy mijë euro dhe subvencionimin

për litër të verës nga 4 cent në 8 cent, si dhe për të gjitha produktet bujqësore pa përjashtim.

Kryeministri Hoti ka thënë se qeveria do të vazhdojë mbështetjen për bizneset edhe për vitin 2021, fillimisht një shumën prej 182 milionë euro e cila pritet të rritet edhe me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë.

Hoti ka paralajmëruar se Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike do të miratohet në Kuvend javën që vjen. "Do të përmbillet kjo çështje, do të definohen edhe mjetet që do t'i marrin qytetarët nga kursimet e tyre dhe një listë e ndryshimeve ligjore përfshirë mundësinë për t'i shtyrë obligimet tatimore, për t'i hequr ndëshkimet e nevojshme për të rishikuar TVSH-në në lëndë të parë të prodhimit vendor e cila ka mbetur një çështje që duhet të adresohet", ka deklaruar ai.

Me këtë rast kryeministri Hoti ka falënderuar Aleancën Kosovare të Biznesit Kosovar, aktivitetet tradicional tash e 18 vjet.



MBPZHR-ja reagon ndaj deklaratave të disa blegtorëve



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes një komunikate për medie ka hedhur poshtë deklaratat e disa blegtorëve, të cilët sipas MBPZHR-së, duke u thirrur në emër të shoqatave të industrisë përpunuese të qumështit, po dezinformojnë se nuk është bërë asgjë për t'i dalë ndihmë këtij sektori

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 NËNTOR- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes një komunikate për medie ka hedhur poshtë deklaratat e disa blegtorëve, të cilët duke u thirrur në emër të shoqatave të industrisë përpunuese të qumështit, po dezinformojnë se nuk është bërë asgjë për t'i dalë

ndihmë këtij sektori. "Nuk janë të saktë insinuatat e personave në fjalë, të cilët po promovojnë aktivitete për mosveprime që kinse ka bërë Kryeministria dhe MBPZHR, në krye me ministrin Besian Mustafa. Në realitet, të njëjtit, permanent kanë përcjellë problemet në këtë sektor dhe kanë marrë për obligim përbushjen e kompensimit të 25 përqind të vlerës së stoqeve të qumështit të freskët dhe

nënprodukteve të qumështit me bazë yndyrën shtazore", është thënë në komunikatën e MBPZHR-së.

Sipas kësaj komunikate, në këtë drejtim janë formuar edhe komisione nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore, të cilët janë duke bërë regjistrimin e fundit të këtyre nënprodukteve. "Procesi i verifikimit të stoqeve është në përfundim e sipër. Pas këtij procesi i cili është çështje ditësh, do të bëhet edhe realizimi i pagesës prej 25 përqind të vlerës, sipas deklaratës dhe vendimit të kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti. Nga ana tjetër, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është ajo e cila po vazhdon me inspektimin dhe ndarjen e produkteve të qumështit me yndyrë shtazore nga ato me përbërje tjetër. Rikujtojmë se vaji i palmës, i cili po apostrofohet nga disa individë se i njëjti duhet ndaluar, është përbërës jo i rrallë në industrinë ushqimore, si në vend, ashtu edhe në tregun evropian dhe më gjerë", është theksuar në komunikatë.

MBPZHR-ja ka njoftuar se është në kontakt të pandërprerë, si me fermerët ashtu edhe me të gjitha shoqatat e fermerëve të Republikës së Kosovës dhe vazhdon të mbetet përkrahëseja më e madhe e punës së tyre.

INDEP-i kërkon të hiqet TVSH-ja nga investimet e energjisë solare

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka kërkuar që të hiqet TVSH-ja për investimet në energjinë solare. "Heqja e TVSH-së nga investimet të energjisë solare do të zvogëlonte kosto të investimeve 18 për qind dhe do të rriste në masë të madhe investimet në këtë sektor", është shprehur Dardan Abazi nga INDEP



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 NËNTOR- Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka publikuar projektin për "Promovimi i Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtrishme në Kosovë". Qëllimi i projektit nga INDEP ishte mbështetja e institucioneve por edhe sektorit biznesor në Kosovës për zbatimin e eficiencës së energjisë dhe arritjes së synimeve të dakorduara nga marrëveshjet ndërkombëtare. Dardan Abazi nga INDEP, ka deklaruar se kanë disa rekomandime për politikbërësit se si duhet vijuar tutje në mënyrë që eficiencia jetë jo vetëm një politikë e imponuar nga Bashkimi Evropian por që të jetë politikë e cila vërtetë shfrytëzon eficiencën për të promovuar zhvillimin ekonomik në vend, rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe për të promovuar siguri të furnizimit me energji elektrike. "Ne po duam që politikbërësve t'iu

ofrojmë disa alternativa, rekomandime se si duhet vijuar më tutje në mënyrë që eficiencia e energjisë të jetë jo vetëm një politikë e cila imponohet nga BE për të përmbushur disa kriterë që na dhënë të tjerët, por që të jetë një politikë e cila vërtetë shfrytëzon eficiencën për të promovuar zhvillimin ekonomik në vend, për të promovuar rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe për të promovuar një siguri të furnizimit me energji elektrike. Eficiencia e energjisë mundëson që të kemi më pak nevojë për prodhim të energjisë nga prodhimet ndotëse dhe të shmangim këto avari me ndërprerje të energjisë elektrike të cilat janë shkaktuar si presion i rritjes së presionit në rrjet dhe rritjes së kërkesë për energji", u shpreh Abazi, i cili ka folur edhe për heqjen e TVSH-së nga investimet e energjisë solare. "Heqja e TVSH-së nga investimet të energjisë solare do të zvogëlonte kosto të investimeve 18 për qind dhe

do të rriste në masë të madhe investimet në këtë sektor. Kjo normalisht ndërlidhet me skemën aktuale të mbështetjes së konsumatorëve me vetëkonsum ne kemi rekomanduar qeverisë që në bashkëpunim me sektorët e tjerë të zhvillojë konsultimet publike dhe të fillojë menjëherë me heqjen e TVSH-së për investime në energji solare sepse kjo do të rriste në masë të madhe investimet në energji solare", ka deklaruar Abazi.

Doruntina Musa, hulumtuese

në INDEP, ka deklaruar se synimi kryesor i projektit ishte që të ngritë vetëdijen dhe të ngritë dialogun mes palëve të interesit në këtë fushë. "Ky projekt ka filluar implementimin që nga dhjetori i vitit të kaluar përmes kësaj konference po e bëjmë përmbylljen. Qëllimi i këtij projekti ishte që të mbështesim institucionet dhe sektorin biznesor të Kosovës drejt zbatimit të eficiencës së energjisë dhe arritjen e synimeve të dakorduara në marrëveshjet ndërkombëtare dhe për planin e eficiencës së

energjisë përbrenda komiteti të energjisë. Për më tepër projekti synon që të ngritë vetëdijen, të nxisë investimet në masat e eficiencës së energjisë nga sektori biznesor si dhe të nxisë dialogun mes palëve të interesit në këtë fushë", u shpreh ajo. Musa ka folur edhe për rëndësinë e eficiencës së energjisë, duke theksuar edhe së fatkeqësisht Kosova varet ende nga prodhimi i energjisë elektrike. Aktivitetet tjetër i INDEP ishte edhe fushata "Miq të energjisë".

Ministri Abrashi: Në afat rekord shpallen llotet e tjera Prishtinë - Podujevë

PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER)- Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me ministrin e Punëve të Brendshme, Agim Veliu dhe ushtruesin e detyrës të kryetarit të Podujevës, Nexhmi Rudari, të premtën kanë ndjekur nga afër asfaltimin e segmentit të katërt të rrugës Prishtinë-Podujevë. Me këtë rast, ministri Abrashi tha se për këtë projekt të rëndësishëm për Llapin, por të neglizhuar nga qeveritë e kaluara, është marrë që nga ditët e para të qeverisë. "Është një prej rrugëve me më së shumti qarkullim por fatkeqësisht edhe me më së shumti aksidente. Ne synojmë t'i përfundojmë në kohë rekorde llotet e kontraktuara dhe sipas inxhinierëve, llotet e tjera, nga Lluzhani deri në kyçe të autostradës, do të shpallen në afat rekord", ka thënë Abrashi. Më tutje, Abrashi tha se ky nuk është projekti i vetëm në Llap. "Në buxhetin e vitit të

ardhshëm, kemi disa projekte që burojnë nga kërkesat e qytetarëve dhe që prekin fshatrat e qytetin e Podujevës. Llapin e prek edhe autostrada Besi-Merdare që është pjesë e marrëveshjes së Uashingtonit. Jemi në negociatat finale për marrëveshje financiare, tani edhe Bashkimi Evropian ka intervenuar me fonde dhe grante, prandaj viti i ardhshëm është një vit në të cilin investimet qeveritare nuk do të mungojnë në Llap", është shprehur ministri Abrashi. Për përkushtimin qeveritar ndaj Podujevës, ushtruesi i detyrës së kryetarit në këtë komunë, Nexhmi Rudari ka falënderuar ministrin Abrashi. "Llapit po i kthehet vëmendja e munguar. Këtë rrugë po e bëjmë për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës sepse e lidhë vendin me Evropën dhe sipas statistikave është më e ngarkuara në nivel vendi", ka thënë Rudari.



Pavarësia e Shqipërisë dhe pasojat e Luftës së Parë Ballkanike 1912-1913



Prof. Dr. Ibrahim GASHI

Vështrim historik

Fillimi i shekullit XX është karakterizuar me ngjarje dhe zhvillime të bujshme pararendëse dhe përcaktuese të ndryshimeve në rendin e ri ndërkombëtar. Efektet dhe konsekuencat e këtyre ndryshimeve gjeopolitike kanë lënë gjurmë të thella veçmas në historinë e popujve të Ballkanit. Studimet më ta avancuara të historiografisë kontemporane kanë identifikuar katër faktorë që i determinuan zhvillimet dramatike në fillim shekullit XX. Së pari, ndarja e botës në dy blloqe kundërshtarë (Blloku i Fuqive Qendrore dhe Blloku i Antantes) dhe rritja e rrezikut të një lufte ndërblokiste për t'i rindarë sferat e influencës. Së dyti, konsolidimi politik dhe forcimi ushtarak i shteteve sllave të Ballkanit (sidomos i Serbisë dhe i Bullgarisë), i inkurajuar nga disa fuqi të mëdha (para së gjithash mendohet në Rusinë). Së treti, Perandoria Osmane, që ende mbante të pushtuar një pjesë të Ballkanit, po jepte shenja të qarta të dobësisë së saj. Pikërisht kjo tani kishte aktualizuar të ashtuquajturën çështje lindore, të cilën Fuqitë e Mëdha (Rusia dhe Austro-Hungaria), por edhe shtetet e Ballkanit donin ta zgjidhnin në favor të tyre. Faktori i katërt veprues që në tërësi këtë proces të krijimit të rendit të ri në Evropën Juglindore kishte rolin më specifik dhe më racional, ishte Lëvizja Kombëtare Shqiptare, e cila mëtonte sendërtimin e platformës së saj politike të shkëputjes nga Perandoria Osmane dhe jetësimin e reserxhimentos (rilindjes) së saj të vonuar. Konfrontimi i këtyre tendencave me prirje të ndryshme rrjedhimisht gjeneroi konfliktin më të madh të armatosur në rajon që i parapriu fillimit të luftës botërore.

Krijimi i Aleancës Ballkanike (mars 1912), si tërësi, dhe nënshkrimi i konventave dhe i anekseve sekrete, ishin sinjalet e qarta për mundësinë e fillimit të luftës në Ballkan. Disponimi i fuqishëm pro luftës i monarkive ballkanike, për të cilën raportoni

të gjithë diplomatët e huaj të akredituar në rajon, e forcojnë konstatimin e sipërthënë. Nga ana tjetër, ndonëse e përmbyllur me suksese të kufizuara, kryengritja e përgjithshme shqiptare (maj-gusht 1912) kishte provuar se status quo-ja në Ballkan ishte fare e paqëndrueshme. Një autor i huaj do të shprehej: "Kryengritja shqiptare i hap rrugë triumfit të aleatëve ballkanikë kundër Turqisë ..." (Ferdinando Salleo, Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri, 35).

Në realitetin e ri të krijuar, Fuqitë e Mëdha, tashmë të ndara në dy aleanca antagoniste, u gjenden përpara një sfide të re. Konflikti eventual ndërmjet aleatëve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane, sipas të gjitha parashikimeve, do të shpinte në një konfrontim përmasash më të gjera, mbase ndërmjet aleancave rivale. Këtu, para së gjithash, mendohej për mundësinë e përfshirjes ushtarake të Rusisë dhe të Austro-Hungarisë për shkak të interesave të tyre të ngushta në rajonin e Ballkanit. Sado që situata e krijuar në fillim të vjeshtës së vitit 1912 dukej shumë serioze, reagimi i Fuqive të Mëdha për evitimin e konfrontimit luftarak qe fare i pavendosur dhe jokonsensual. Iniciativat konkrete të fuqive të veçanta si ajo e Berhtoldit, ministrit të Jashtëm austro-hungarez, dhe ajo e homologut të tij francez, u pritën ftohtë dhe nuk u mbështetën nga fuqitë e tjera. Rrjedhimisht efektet e tyre qenë të pandjeshme.

Përveç momenteve të zëna në gojë, ndoshta një motiv më shumë që i inkurajoi aleatët ballkanikë për fillimin e luftës ishte tensioni rreth e qark Perandorisë Osmane i shtuar në mënyrë të ndjeshme gjatë vitit 1912. Në tërësi këtë spektër faktorësh dhe interesash me prirje për luftë, nisi më 9, vërtet më 17 tetor 1912 Lufta e Parë Ballkanike.

Pa elaboruar zhvillimet operacionale në të gjitha frontet dhe fushëbetet veç e veç po mjaftohemi me një konstatim, se sulmi i ushtrive ballkanike qe i furishëm dhe i suksesshëm. Për shumë analistë dhe historianë mbetet enigmatik fakti i rezistencës së dobët të ushtrisë osmane. Ushtritë osmane pas rezistencës që ofruan në ndeshjet e para, nuk treguan vullnet dhe vendosmëri të duhur për të vazhduar atë deri në fund. Konsekuencat e kësaj taktike ishin apriori ta qarta. Ushtritë ballkanike marshonin përpara dhe çdo pëllëmbë e re e tokës së

fituar ishte një stimulim i madh jo vetëm moral për ta vazhduar luftën. Nga ana tjetër, betejat e humbura dekurajonin dhe destabilizonin së tepërmi radhët e ushtrisë osmane. Rrjedhimisht, shpejt u krijua epërsia e pariparueshme pothuaj në të gjitha frontet.

Një moment me rëndësi të ndjeshme në epilogun e luftës konsiderojmë se ishte edhe trajtimi joadekuat i forcës ndihmëse që ofronin vullnetarët shqiptarë. Këtë faktor e injoroi kreu ushtarak osman. Osmanët as në momentet kur po i humbnin zotërimet e tyre të fundit në Ballkan, nuk u treguan të gatshëm t'i njihnin aspiratat çlirimtare të shqiptarëve dhe t'i mbështesnin ata për realizimin e tyre. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë u injorua dhe u pengua njësoj si nga aleatët ballkanikë, ashtu edhe nga Porta e Lartë. Pati vetëm një përjashtim nga kjo politikë. Komandanti dhe guvernatori i Shkodrës, Hasan Riza Pasha, duke e njohur aktin e pavarësisë së Shqipërisë dhe duke e zëvendësuar flamurin turk me atë shqiptar në Kalanë e Shkodrës, bëri mrekullinë më të madhe të luftës. Shqiptarët, të inkurajuar nga ky hap, luftuan deri në pikën e fundit të gjakut të tyre për mbrojtjen e qytetit dhe vërtet e arritën atë. Pra, siç kemi konstatuar më se një herë, Shkodra, përkundër një rrethimi të hekur shtatëmuajor, me forca superiore serbo-malazeze nuk u gjuhëzua. Kjo ndoshta është dëshmia më e mirë për konsekuencat e politikës së gabuar osmane në raport me shqiptarët në vitet e Luftës së Parë Ballkanike.

Kur bëhet fjalë për shqiptarët unë kam ndarë mendimin se Lufta e Parë Ballkanike dhe çështja shqiptare përbëjnë eventimet më komplekse në zhvillimet ballkanike të fillimit të shekullit XX. Po të shikohet nga një perspektivë realiste fillimi i luftës së aleatëve ballkanikë, për çlirimin e tokave të Ballkanit që akoma ndodheshin nën sundimin osman, në një kohë kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare po ashtu ndodhej në kulmin e përpjekjeve të saj çlirimtare, atëherë rrjedhimi më i mundshëm dhe logjik do të duhej të ishte bashkëveprimi i këtyre dy tendencave çlirimtare kundër armikut të njëjtë.

Historianët e vendeve që dikur i takonin Aleancës Ballkanike asnjëherë nuk kanë pasur kurajën e duhur për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që pashmangshëm imponohet me këtë rast: Përse shqiptarët nuk ishin përfshirë si

aleati i pestë në Aleancën Ballkanike? Në vend të kësaj ata në vazhdimësi kanë ngritur tezën akuzuese për qëndrimin "proturk" të shqiptarëve, pa provuar asnjëherë të zbulojnë arsyet e vërteta të qëndrimit neutral të shqiptarëve. Edhe historiografia shqiptare nuk ka arritur bindshëm ta ndriçojë tërë kompleksitetin e këtij problemi. Në fakt, ajo ka identifikuar vetëm një pjesë të faktorëve që e kanë penguar partneritetin e shqiptarëve dhe fqinjëve të tyre në luftë kundër sundimit osman. Që këtëj kjo çështje edhe më ka ngelur pa një përgjigje të plotë. Konsultimi i një provenience dokumentare gjermane dhe angleze ka qenë shtytje që të orvatem t'i identifikoj disa nga barrierat që e pamundësuan asocimin e shqiptarëve në aleancën ballkanike me çka historia e popujve të Ballkanit sigurisht se do të kishte pasur rrjedhë tjetër.

Së pari, principet themelore mbi të cilat ishte ngritur aleanca ballkanike nuk ishin principe të motivuara nga ideja çlirimtare, siç proklamohet, por principe të motivuara nga ideja e profitit territorial nga lufta që duhej filluar;

Së dyti, pika më e nxehtë në negociatat për krijimin e aleancës ballkanike kishte qenë ajo për caktimin e vijave ndarëse të territoreve që do të pushtoheshin, mbase edhe të aneksoheshin nga secili aleat ballkanik, në rast të triumfit eventual. Lidhur me këtë madje ekzistonin divergjencat të theksuara, ku secili nga aleatët kishte kërkuar për vete maksimumin dhe vetëm ndërhyrja e diplomacisë ruse kishte ndihmuar në kapërcimin e këtyre divergjencave dhe krijimin e aleancës.

Së treti, territoret e okupuara nga osmanët, që do të "çliroheshin" nga aleatët ballkanikë, në pjesën më të madhe ishin territore të banuara me shumicë, mbase edhe etnikisht të pastra shqiptare. Realiteti i tillë etnik rrjedhimisht kishte prejjudikuar një qëndrim shumë të ftohtë deri në shkallë injorimi të aleancës ballkanike ndaj faktorit shqiptar. Ky i fundit në mënyrë të vazhdueshme ishte kundruar si pengesë dhe jo si favor në planet e aleatëve ballkanikë.

Së katërti, një moment tjetër që, po ashtu, imponohet të marrë përgjigje, është dilema se a qenë krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare mjaft fleksibilë në relacionet e tyre me fqinjët ballkanikë dhe sidomos a i kishin bërë sa duhet të qarta përpara opinionit ballkanik objektivat për

të ardhmen e vendit të tyre. Këtu mendojmë se ka vend për t'i analizuar të metat për organizimin e lëvizjes kombëtare të cilat mund të kenë influencuar në rrjedhën e disfavorshme të situatës për shqiptarët. Po qe se jemi më të drejtpërdrejtë, aludimet tona kanë të bëjnë me qëndrimin e çuditshëm të krerëve të Kryengritjes së Përgjithshme Shqiptare. Pranimi i një autonomie të ngushtë dhe të pagarrantuar nga askush në kuadër të Perandorisë Osmane pas një fitoreje në fushë të betejës, (fjala është për kryengritjen e përgjithshme shqiptare të vitit 1912) mbase përbën kthesën fatale për shqiptarët drejt realizimit të synimeve të tyre çlirimtare. Ky qëndrim i padefinuar si duket ishte momenti më vendimtar për inkurajimin e aleatëve ballkanikë që t'i injoroni plotësisht shqiptarët dhe aspiratat e tyre. Këto janë vetëm disa nga momentet që mund t'u referohemi për zbulimin e motiveve kryesore që determinuan qëndrimin e Aleancës Ballkanike ndaj shqiptarëve dhe anasjelltas. Shqiptarët, duke parë se po e humbnin edhe rastin e fundit, në një kohë kur tokat e tyre pothuaj në tërësi ishin pushtuar nga ushtritë ballkanike, vendosën t'i mblidhnin energjitë e tyre të mbetura për të shpëtuar atë që mund të shpëtohej në aktualitetin e krijuar. Në rrethana shumë të ndërlikuara të brendshme, më 28 nëntor 1912 u shpall pavarësia e Shqipërisë. Ky, megjithatë, ishte reagimi më i pjekur dhe më vendimtar i shqiptarëve për zbutjen e përmasave të tragjedisë që i kishte përfshirë.

Një kaptinë interesante në krizën ballkanike përbën çështja e pozicionimit të Fuqive të Mëdha karshi pavarësisë shqiptare. Tratativat diplomatike dhe debatet e gjata në Konferencën e Ambasadorëve në Londër për muaj me radhë e kishin ngritur çështjen shqiptare në një çështje të dorës së parë, duke sinjalizuar të gjithë aktorët ballkanikë se ajo nuk mund të anashkalohej tërësisht. Posaçërisht preokupimet e Fuqive të Mëdha, në një anë dhe të aleatëve ballkanikë, në anën tjetër, qenë të lidhura me territorin në të cilin do të shtrihet shteti i ri shqiptar. Aleatët ballkanikë dhe mbështetësit e tyre nga radhët e Fuqive të Mëdha (Rusia dhe Franca) kishin pranuar ta njihnin krijimin e një shteti autonom shqiptar në një territor të ngushtë, fare të papërfillshëm,



për ta privuar kështu atë nga mundësitë që të mbijetonte ekonomikisht dhe politikisht. Nga ana tjetër, fuqitë e trepalëshes, sidomos Austro-Hungaria dhe Italia, kishin treguar interesim të veçantë për konsolidimin e shtetit shqiptar, me rastin e caktimit të kufijve të tij me fqinjët ballkanikë. Vjena dhe Roma me intrasigjencë e kishin kundërshtuar daljen e Serbisë në Adriatik. Austro-Hungaria ishte treguar e ngurtë edhe me rastin e diskutimit të mundësisë për t'i dhënë Shkodrën Malit të Zi. Pas përçapjeve të dendura diplomatike, Vjena kishte deklaruar madje edhe mundësinë e intervenimit të njëanshëm kundër Malit të Zi në rast se mungon një disponim i përbashkët i Fuqive që Shkodra t'i mbetet Shqipërisë. Edhe Italia, nga ana e saj, kishte qenë këmbëngulëse me rastin e caktimit të kufirit jugor që do të ndante Shqipërinë me Greqinë, sidomos pjesës bregdetare të këtij kufiri. Të dy këto Fuqi, në emër të kompromisit, në Konferencë kishin pranuar të sakrifikon krahina me përbërje etnike thjesht shqiptare në pjesën kontinentale të kufirit për të shpëtuar pikat e rëndësishme veçantë strategjike të bregdetit shqiptar siç janë Shkodra, Durrësi, Sazani etj., që të mos binin në duart e aleatëve ballkanikë por t'i mbeteshin shtetit shqiptar. Mendoj se arsytet e një qëndrimi të tillë të Fuqive të përmendura të Trepalëshit buronin nga platforma e interesave strategjike të tyre për të penguar depërtimin eventual të Rusisë përmes aleatëve ballkanikë në bregdetin shqiptar të Adriatikut, gjë që do të rrezikonte seriozisht interesat e tyre. Përveç kësaj, Austro-Hungaria po vepronte edhe mbi bazën e një politike tradicionale, të pranuar ndërkombëtarisht, të protektoratit kulturor mbi shqiptarët katolikë të Shqipërisë Veriore me qendër Shkodrën. Injorimi i shqiptarëve dhe i aspiratave të tyre çlirimtare nga

aleatët ballkanikë dhe sidomos ndërhyrja brutale e ushtrive të tyre në vendbanimet shqiptare rezultoi me dëmtimin ekstrem dhe të pariparueshëm të marrëdhënieve relativisht të qeta ndërfqinjësore deri në këtë kohë. Tani shqiptarët për një moment do të ndodhën, të vetmuar, të pambrojtur dhe të urreyer nga të gjithë. Qenia e tyre nacionale ishte rrezikuar seriozisht. Ndërhyrja e ushtrive ballkanike dhe tërheqja e shpejtë e ushtrive osmane kishte krijuar një vakum që nuk arriti ta përmbushte me sukses rezistenca e vullnetarëve shqiptarë. Në fakt, shqiptarët në rrethanat e krijuara nuk arritën ta krijonin një front unik të rezistencës për të ndaluar marshimin e ushtrive ballkanike dhe dëbimin e ushtrive osmane, me çka do të ndërrojnë rrjedhën e historisë në favor të tyre. Së këndejmi ata do të jenë të destinuar që të bartin konsekuencat e Luftës së Parë Ballkanike. Me këtë rast po e citojmë autorin amerikan të ditëve tona Richard Hall-in, i cili në mënyrë shumë autentike ka përmbledhur dhe prezantuar një pjesë të këtyre informacioneve që kanë të bëjnë me konsekuencat e luftës për shqiptarët. Në përfundimet e veprës së e tij ai do të konstatojë: "Shumë shqiptarë luftuan në radhët e ushtrive osmane, të tjerët rezistuan kundër invaduesve grekë, malazez dhe serbë. Fushata pushtuese e këtyre të fundit la prapa vetes numër të pallogaritshëm të viktimave civile dhe shkatërrime në të gjitha krahinat e vendit. Pa dyshim, veriu dhe jugu, krahinat më luftime me intensive dhe regjione të pushtuara nga invaduesit përjetuan ndryshime, përkatësisht humbje të mëdha demografike" (The Balkan War 1912-1913, 141). Nga analizat tona në këtë punim të lidhura më dramën shqiptare të viteve 1912-1913 rezultoi se Lufta e Parë Ballkanike ishte goditja më e rëndë me pasoja afatgjate mbi relacionet edhe

ashtu të brishta ndërmjet shqiptarëve dhe fqinjëve të tyre. Në veçanti pjesa e territoreve shqiptare që mbeten jashtë shtetit shqiptar të krijuar në vitin 1912 iu nënshtruan për një shekull një politike të jo tolerancës, të keqtrajtimin dhe persekutimit permanent që herë pas here arrinte në përmasat e gjenocidit dhe të spastrimit etnik. Përmasat e dhunës dhe brutaliteti që përdorën ushtritë e Aleancës Ballkanike në operacionet e tyre në Kosovë dhe në Shqipëri nuk arritën t'i shpëtonin syrit të opinionit perëndimor. Masakrat masive dhe toka e djegur që linin prapa vetes këta trupa po e shndërronin luftën ballkanike në konfliktin e përmasave më të mëdha shfarosëse të shekullit. Shumë misionarë, diplomatë e zhurnalistë evropianë, që rastësisht a me shkas u ndodhën në Ballkan, kanë lënë dëshmi rrëqethëse për krimin e kryer nga këto ushtri mbi shqiptarët. Është e pamundur të trajtohet në mënyrë shteruese i tërë vëllimi i literaturës, shtypit dhe i burimeve dokumentare evropiane mbi këtë çështje në një punim si ky që ka më shumë karakter përkujtues të aktit historik të mëvetësimin të Shqipërisë. Në vijim po sjellim vetëm disa dëshmi të vet autorëve serbë dhe të huaj mbi përmasat e krimeve serbe të Luftës së Parë Ballkanike kundër shqiptarëve. Socialdemokrati serb Dimitrije Tucoviq në ditarin e tij të luftës, të cilin ai e mbajti me pedanteri të rrallë deri në çastet e fundit të jetës (u vra gjatë tërheqjes së ushtrive serbe përpara ushtrive austro-hungareze në fillimet e Luftës së Parë Botërore, më 20 nëntor 1914), do të shënojë edhe këtë fakt: "Turqit e udhëhoqën këtë luftë shumë më ndershmërisht se ne... ushtritë që ndërhyjnë në të katër anët e trevave që i mbanin osmanët (ushtritë ballkanike, v. j.), dogjën, prenë, vranë, morën dhe shkretëruan për një vit më tepër se ç'kishin bërë ushtritë e sulltanit për njëqind vjet.

"Nga krahinat e pushtuara, e nis rrëfimën e saj Miss Edith Durham, vinin lajme të dhembshme mbi mizoritë e paduruara që bënin si serbët, ashtu edhe malazeztë mbi shqiptarët. Dhe në vend që t'i fshihnin veprat e tyre ata përkundrazi mburreshin me to. Një oficer serb për pak sa nuk u mbyt në kupën e birrës, derisa më rrëfente se si ushtarët e tij kishin shpuar në bajonetë gratë dhe fëmijët e Lumës". Në vjeshtën e vitit 1912 L. Trocki, teoricieni dhe revolucionari marksist rus, u dërgua në Ballkan që të raportonte për gazetën më të popullarizuar majtiste në Rusinë Jugore Kievskaya Mysl. "Në Shkup arritëm në orën 10 të mbrëmjes, e fillon rrëfimën ai. I tërë qyteti ishte i qetë, askund s'kishte njeri të gjallë. Vetëm përpara stacionit hekurudhor ishte një grup ushtarësh. Secili që udhëtoi me tren shkoi rrugës së vet, duke më lënë mua vetëm në stacion. Shkova te grupi i ushtarëve. Katër ushtarë mbanin bajonetat gati, kurse në mes të grupit qëndronin dy shqiptarë shumë të rinj me kapela të bardha. Një ushtar jo i rregull (komit-çetnik) i dehur në një dorë mbante thikën e në tjetrën shishen e rakisë. Komiti jepte urdhra: "Poshtë!" Shqiptarët gjysmë të vdekur nga frika ranë në gjunjë. "Lart!" ata u ngritën. Kjo u përsërit disa herë. Pastaj komiti duke u kërcënuar dhe duke sharë drejtoi thikën në fytyrë dhe gjokset e viktimave, duke i detyruar të pinin rakë pastaj i puthi. I dehur nga fuqia e rakisë dhe gjaku argëtohej duke lozur me ta si macja e egër me minjtë. Tre ushtarë të tjerë që nuk ishin të dehur rrinin të qetë dhe të kujdesshëm që të mos u iknin shqiptarët.... "Ata janë arnautë",

më tha njëri nga ushtarët besueshëm. "Tani do t'i therë". "Në qytet apo nëpër rrugë ishte aq qetë sikur ky vend të jetë i braktisur. Të gjitha dyert dhe portat ishin të mbyllura qysh në orën gjashtë pasdite. Komitet natën kryenin punën e tyre. Hynin nëpër shtëpitë turke dhe shqiptare dhe kryenin zakonisht të njëjtën detyrë grabitjeje dhe vrasjeje. Dy ditë para ardhjes sime në Shkup, gjëja e parë të cilën banorët e panë në mëngjes, kur u zgjuan ishte grumbulli i kufomave shqiptare me koka të hequra nën urën kryesore të Vardarit, në vetë qendrën e qytetit. Sidoqoftë, ishte e qartë se ata njerëz me koka të hequra nuk ishin vranë në luftë". Në përmbyllje të këtij shkrimi, për ta kuptuar karakterin dhe synimet e vërteta të Luftës së Parë Ballkanike dhe pasojat që ajo prodhoi për marrëdhëniet shqiptaro-serbe, po i referohemi historianit të mirënjohur perëndimor Noel Malcolm, i cili në përfundimet e veprës së tij mbi Kosovën, shprehet: "Sipas historisë mitike të serbëve, ajo që ka ndodhur në Kosovë, më 1912, ka qenë një akt i çlirimit, që e shpëtoi një popull të shtypur nga një lloj sundimi të huaj kolonial është një element i së vërtetës në këtë pohim, por kjo është shumë më pak se e tërë e vërteta. Serbët kurrë nuk do të kuptojnë natyrën e problemit të Kosovës, në qoftë se nuk pranojnë se territori i pushtuar, më 1912, kishte pasur që më parë një shumicë të popullatës joserbe, dhe, së dyti se eksperiencia e një sundimi të huaj kolonial është pikërisht ajo që ia imponoi me dhunë Serbia shumicës së popullatës gjatë gjithë shekullit..."

(Autori është profesor i rregullt në Universitetin e Prishtinës)



Poezi nga Andon Z. ÇAJUPI

Mëmëdheu

Mëmëdhe quhetë toka
ku më ka rënuarë koka,
ku kam dashur mëm'e atë,
ku më njeh dhe gur' i thatë
ku kam pasurë shtëpinë,
ku kam njohur perëndinë,
stërgjyshët ku kanë qenë
dhe varret q'i kanë vënë,
ku jam rritur me thërime
ku kam folur gjuhën time,
ku kam fis e ku kam farë,
ku kam qeshur, ku kam qarë,
ku rroj me gas e me shpres,
ku kam dëshirë të vdes.

Komuna e Mitrovicës do t'i ndihmojë me nga 50 euro qytetarët e infektuar me Covid

MITROVICË, 27 NËNTOR (ER)- Nën drejtimin e kryesuesit, Safet Kamberi, dhe në prani të nënkryetarit të komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, asamblistëve dhe drejtorëve të administratës komunale, është mbajtur seanca e 39-të e rregullt e Kuvendit të Komunës. Në këtë mbledhje

u propozuan si pika shtesë për rend dite; Propozim-vendimi për formimin e komisionit për hartimin e draft-rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve; Propozim-vendimi për miratimin e rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat, lagjet

dhe vendbanimet urbane të Mitrovicës; Propozim-vendimi për mbështetje financiare të pacientëve të infektuar me virusin Covid-19. Sipas këtij vendimi Komuna e Mitrovicës do t'i ndihmojë me nga 50 euro qytetarët e infektuar me Covid.



Përurohen tualetet publike në Parkun e Lirisë në Ferizaj



FERIZAJ, 27 NËNTOR (ER)- Mungesa e deritanishme e tualeteve publike në Parkun e Lirisë, ka bërë që megjithë investimet e kryera në këtë zonë, të mungojë infrastruktura e nevojshme për qytetarët. Në këtë funksion, për ndërtimin e tualeteve publike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, bëri planifikimin e

nevojshëm buxhetor që të realizohet ky projekt. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu bashkë me drejtorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Zekir Bytyqi, dhe disa drejtorë tjerë të komunës, ka përruar këtë projekt. Ky i fundit, drejtori Bytyqi tha se me këtë investim tejet të nevojshëm për qytetarët që

frekuentojnë këtë zonë po kompletohet infrastruktura e domosdoshme në Parkun e Lirisë, duke kujtuar këtu edhe investimet e kryera në rregullimin e shtigjeve për ecje, ndërtimi i Këndit të Lojërave dhe asfaltimi i rrugës që shpie në këtë park si dhe investimet tjera të kryera nga pushteti lokal në këtë zonë.

Shoqata "Busavata" nga Zvicra ia dhuron dy shtretër QKMF-së në Gjilan

GJILAN, 27 NËNTOR (ER)- Shoqata e bashkatdhetarëve nga Zvicra "Busavata", përmes klubit rotarian Gjilani, i ka dhuruar dy shtretër për nevoja të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan.

Kryetar i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka falënderuar këtë shoqatë për mbështetjen sikurse edhe klubin e rotarianëve për bashkëpunimin e vazhdueshëm në të mirë të komunitetit. "Unë i falënderoj, po ashtu, edhe mjekët e infermierët për punën e madhe

që kanë bërë në këtë kohë pandemie", ka thënë Haziri.

Gëzim Klokoci, president i klubit rotarian Gjilani, ka thënë se shpreson që në këtë kohë pandemie këta dy shtretër do t'ju shërbejnë pacientëve të kësaj komune.

Në këtë ngjarje ka folur edhe drejtori i Shëndetësisë, Selami Xhemaili dhe drejtoresha e QKMF-së, dr. Arbenita Hajdari, të cilët kanë falënderuar donatorët për këta dy shtretër, të cilët kanë qenë të nevojshëm për trajtimin e pacientëve aty.



Fillon implementimi i vendparkingjeve publike me pagesë në Prishtinë

PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER)- Rrugët "Fehmi Agani" dhe "Rexhep Luci" janë dy rrugët e para ku do të fillojë implementimi i vendparkingjeve publike me pagesë në kryeqytet, për t'u zgjeruar gradualisht në të gjithë qytetin.

Këto parkingje do të kenë disa mundësi të pagesës, me aplikacion, SMS (Vala dhe Ipko), biletë dhe pajisje. Kohëzgjatja maksimale për parkim për qytetarët jorezident të këtyre lagjeve është dy orë dhe pagesa kalkulohet me minutat e kohëzgjatjes së parkimit. Banorët rezident të lagjeve kanë përparësi, mund të parkohen për 24 orë dhe kanë pagesa mujore. Mospagesa e tarifës rezulton me bllokim të

veturës, dënimin prej 25 euro dhe shpenzimet e merimangës.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se ky projekt do të ndihmojë menaxhimin më efikas të parkingjeve publike dhe kohës së qytetarëve, sepse, sipas tij, përmes aplikacionit do të kenë informata në kohë reale se cilat vendparkingje janë të lira për shfrytëzim në zonën ku jeni. "20 kontrollorët e parë, pjesë e stafit të ndërmarrjes 'Prishtina Parking' janë në proces të përfundimit të trajnimit, në mënyrë që të fillojnë punën në terren qysh javën e ardhshme", ka bërë me dije kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti.





Kush e hartoi alfabetin e gjuhës shqipe?

(Diskutimi në të përkohshmet “Kumbona e së Diellës” dhe “Hylli i Dritës”)

Përgatiti **Andreas DUSHI**

Në numrin 8 të vjetit V, datë 22 Fërueer (Shkurt) 1942, e përjavshmja *Kumbona e së Diellës* çelet me kryeartikull «Emzot Prengë Doçi» të shkruar nga Dom Nikollë Sahatçia. Me detaje, ai tregon jetën dhe veprën e klerikut e gjuhëtarit të shquar. Mes të tjerash, thotë:
Në vjetin 1899, bashkë me Dom Ndoc Nikajn, themeloi ma të paren shoqni letrare në Shkoder, shoqnin “Bashkimi”. Kjo shoqni i dha shkas të madh zhvillimit të gjuhës shqipe që Dera e Stambollit donte m’e zhdukë, kurse ndalote çdo botim në ket gjuhë e dënonte randë autorin, e veç toleronte botimet me subjekt fetar. Prandaj Emz. Doçi kësaj shoqnie i dha ngjyrë fetare, e pjestarët e saj i zgjodh prej klerit: françeskaj e priften. Posë librave të botuem, prej kësaj shoqnie kemi Alfabetin që Kongresi i Manastirit, mbajtë në Nanduer 1908, e miratoi, duke i bërë pak ndryshime.
Pra, sipas Sahatçisë, është pikërisht alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” ai që u zgjodh nga Kongresi i Manastirit për të qenë alfabeti i gjuhës shqipe. Paraprakisht, le të sqarojmë

pak si u krijua kjo shoqëri. Në parathënien e ribotimit të *Fialuer i Rii i Shqypes, Perbâam prëie Shocniit t’Bashkimit*, (Botimet Fishta, 2018), Nikë Ukgjini citon Dom Ndoc Nikajn i cili, si dëshmitar i kohës, flet se si kjo shoqëri zë fill në vitin 1893 kur bëhet një takim mes Doçit dhe disa klerikëve:
[Shoqëria Bashkimi] kishte për detyrë Bashkimin e Shqyptarve pa dallim feje dhe fisi... U lidhme me shkruar në giuhen shqype, seicili si mbas andjes së vet dhe si mbas prijet përkatëse.
Në vitin 1899, kjo shoqëri merr formën e vet zyrtare nën emrin “Bashkimi”. Në takimin themelues të saj ishin: Imzot Preng Doçi, Imzot Lazër Mjeda, Dom Jak Sarreqi, Atë Gjergj Fishta, Dom Ndoc Sheldia, Dom Gjon Koleci, Dom Mark Shllaku, Atë Pashko Bardhi, Dom Ndoc Nikaj, Dom Dodë Koleci, Dom Mëhill Çuni, Mati Logoreci, Gasper Beltoja dhe Ndue Paluca. Kryetar i saj u zgjodh Preng Doçi.
Për t’u rikthyer te tema e alfabetit, po në *Kumbonën e së Diellës*, pak muaj më vonë, përkatësisht më datë 17 Mâjë 1942, numrin 20, Gjon Ujka nën pseudonimin *Lul Shkurti* shkruan një artikull me titull

DO OROE
permi shkroié e théksa

Shkroiét e giuhes shcypé iáne triidhété e kater: a, b, c, ch, d, dh, e, f, g, gh, gn; h, i, k, l, ll, m, n, nn, o, p, r, rr, s, sh, t, th, ts, v, u, (*) y, x, xh, z.

Shkroiét a, e, i, o, u, y, iáne xántoré.

Shkroia e paa thékse hiédhse si t’mos icet n’ fillim t’ fiales, a m’ gnirroktsa nuk shcypthét. Iosé fort leet kuur t’ ghinnét mrénne n’ fiale, e n’ marim t’ ksaie kurr, sikur-sé: atehere, perhere, pûne, burre, etr.

Shënjime rreth alfabetit.
Ai kundërshton pohimin e Sahatçisë duke thënë:
I vleri D. Nikollë Sahatçija n’ artikullin kujtimuer që ka botue në “Kumbonë” nr. 8 permbi atdhetarin e madh Imz. Prengë Doçin, paraqet pohimin se alfabeti që na përdorim sod nuk është tjetër, por ai i “Bashkimit” të cilin Kongresi i Manastirit e miratoi me pak ndryshime.
Është një gabim në të cilin pa dash të bjen shumëkush, ky që me kujtue se alfabeti i “Bashkimit” kje ai që, me pak ndryshime, u pranue prej Kongresit të Manastirit i cili i dha fund çështjes atëherë aq të vshtirë t’alfabetit tue adoptue dy alfabetna, prej të cilit i dyti është ky që na kemi sod, por që qyshë atëherë u parashifte se do të mbetej i vetmi në përdorim të përgjithshëm. Prandaj, mbasi faktet historike shumë herë harrohen, besoj se nuk është keq me kërkue e me pa se çka alfabeti i sotshëm ka marrë e çka ka lënë prej atij të “Bashkimit”.
Para se të vijojmë, të shohim cilat janë shkronjat e alfabetit të “Bashkimit”, marrë nga faqja VII e *Fjalorit* të hartuar prej shoqërisë në fjalë:
Bazuar në këtë, Ujka argumenton:
Tue lënë jashtë gerrat që i

kanë të perbashkëta me të tjerë dy alfabetat, një shqyrtim i këtyne ka me na ditue se n'alfabetin e sotshëm gjinden vetem pesë germa t'atij të "Bashkimit", d. m. th. **dh, ll, th, sh e rr**. Perkundra janë lënë jashtë prej si dymbëdhjetë germa me vlerë fonetike që këto kishin n'atë alfabet... Në vënd të germave të perjashtueme prej atij të "Bashkimit", alfabeti i Manastirit mori shtatë prej atij të "Stambollit" e të "Agimit"... e pesë të tjera i shtinë së parit në perdorim.

Duhet thënë se Shoqria e Stambollit, e njohur ndryshe si Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip u themelua më 12 tetor 1879 në Stamboll nga disa intelektualë shqiptarë si Sami Frashëri, Pashko Vasa e të tjerë, ndërsa Agimi "lindi" nga gjiri i Bashkimit kur dy vëllezërit Mjeda, Imzot Lazri dhe dom Ndreu u shkëputën duke krijuar shoqërinë e tyre letrare.

Por pse ndodhi kjo shkëputje? Është shkruar shumë rreth kësaj teme, ama studiuesi më pasionant i jetës dhe veprës së dom Ndre Mjedës mbetet Mentor Quku me dhjetë vëllimet kushtuar personalitetit të tij. Në të tretin, ai flet gjerë e gjatë për këtë temë duke cituar njerëz që dëshmuuan gjithë çfarë ndodhi, mes tyre edhe vetë Imz. Doçin që, në një letër dërguar Golluhskovit më 11 gusht 1903 shkruan:

Dom Ndre Mjeda, i liru prej shoqërisë Jezuitëve, që vendosur në Abacinë e Mirditasve prej meje, kryesisht që talentin e vet t'ia konsakronte kësaj shoqërie letrare [Bashkimit]. Por ai, që më përpara kishte deklaruar se është gati të sakrifikojë edhe opinionet e tij private për dëshirat e mija, u shfaq kundërshtar në mbledhjen e parë (qershor 1899) në të cilën që ftuar si anëtar i saj, pasi pa se nuk arrinte t'ia ndryshojë programin veçanërisht lidhur me alfabetin e saj ose të shkëpusë pjesëtarët e saj nga qëllimi për ta mbajtur.

Më pas, ai citon Dr. Ranzin i cili në raportin e tij për Doçin thotë: *Mbledhja tjetër e "Shoqërisë për unifikimin e gjuhës shqipe", u bë... Përveç Dom Andrea Mjedës, që u shkëput nga shoqëria, të gjithë anëtarët e tjerë u solidarizuan plotësisht me mënyrën e re të shkrimit duke hequr dorë nga pretendimet apo vërejtjet e tyre të mëparshme.*

Deri tani, del se arsyeja e vetme e shkëputjes së Mjedës nga "Bashkimi", ishte çështja e alfabetit. Tani le të shohim se kur dhe si zë fill "Agimi" duke përmendur një letër të Atë Pashko Bardhit dërguar Mid'hat Frashërit në vitin 1929, marrë gjithashtu prej po të

njëtit libër: *Kundërshtari ma i pari e ma i madhi i alfabetit të Bashkimit ka kenë Dom Ndre Mjedja. Ky, në të dytën mbledhje, në të cilën së parit muer pjesë si pjesëtar i Bashkimit, ju kundërshtue alfabetit, e lypete një alfabet me sheja diakritike. Pak mbrapa kje ba ipeshkëv Dom Lazer Mjedja, i cili filloi me mbështetë vllaun e vet Dom Ndren, e bashkë me t'Emzot Prend Biankun, kryepeshkvin e Durrcit e me t'Emzot Pashko Trokshin kryepeshkvin e Shkupit, bane në mnyrë që t'u bate në Shkodër një mbledhje ipeshkvijshe, për me caktue një alfabet të pergjithshëm për Gegni. Se i cili ipeshkv muer me vedi në këtë mbledhje ka një meshtar... Në këtë mbledhje, Dom Ndre Mjedja propozoj alfabetin e vet kundra atij të Bashkimit, e kështu bani edhe Dom Gasper Jakova. Mbledhja u shpernda, pa marrë një farë vendimi. Atëherë Bianku, Trokshi e L. Mjedja u mblodhen në Nenshat... e ktu pranuen alfabetin e Ndre Mjedjes e themeluen shoqërinë Agimi. Kta ndodhi në vitin 1901.*

Tani le të rikthehemi sërish të shkrimi i Ujkës rreth çështjes së alfabetit:

Prandaj shifet kjarë se tue u pranue prej shtatëmbëdhjetë germave, vetem pesë t'alfabetit të "Bashkimit" e tue u perjashtue dymbëdhjetë, nuk ka si thohet se ky i sotshmi nuk është tjetër veçse i pari me pak ndryshime.

Sikurse është dëshmue prej pjestarëve të Kongresit, alfabeti i sodshem është veper e D. Ndre Mjedës i cili, në mes t'antithesave të ndryshme që u shfaqne në gji të Kongresit, që ishin duke vue në rrezik të mbërritunin e qellimit të tij..., ja doli në krye të qellimit tue propozue alfabetin e sodshëm, i cili u pranue prej Kongresit..., pa kurrnj ndryshim.

Alfabeti i "Bashkimit", sikurse e thekson edhe i ndritëshmi gjuhëtar Atë Justin Rrota O. F. M. në veprën e vet të çmueshme "Për historin e alfabetit shqyp", nuk ishte i themeluem mbi baza shkencore...

Artikulli, mandej, vijon duke treguar e shpjeguar tipare të alfabetit që përzgjedhi Kongresi dhe duke vënë në dukje ndonjë mungesë të tij. Por nuk është ky objekti i këtij shkrimi.

Në Hylli i Dritës, vjeti 1942, numri i mars – prillit, Atë Pashko Bardhi boton një artikull, gjithashtu për Doçin. Mes të tjerash, në faqen 129 – 130, ai shkruan:

Në Pjesën e dytë të "Zanit të Shna Ndout", un kam botue do shenjime historike mbi alfabetin e gjuhës shqype, në numrin e Qershorit 1920, faqe 153 – 155 kam shkruar mbi shoqëritë letrare "Bashkimi" e

"Agimi" e mbi kongresin e Manastirit gjënësisht njashtu si jam tuj shkruar sot. At herë, në mos të gjith, nemose shumica e atyne që kanë marrë pjesë në kongres të Manastirit, kanë kënë gjallë, e gjallë ka kënë edhe D. Ndre Miedia. E asnjë nuk është gjetun që u ka kundërshtue fjalvet të mija, pse të gjithë e kanë dijtë se un tjetër së kam bërë, veç kam kallxue të verteten. E tash, mbasi kanë kalue 33 vjetë që se është mbajtë kongresi i Manastirit..., po ka asish të cilët, tuj shtrembnue të verteten historike, duen me i kallxue rrjedhjet e punvet në kongres të Manastirit krejt ndryshe se kanë kënë në realitet. Këta do me thanë: I zoti e jep, e tellalli s'e jep.

Kjo pjesë e shkrimit mbyllet me një pohim interesant i cili, kundërshtisë me nota të forta i jep një sens të lehtë dashamirësie. Por më përpara, le të lexojmë se për çfarë artikulli flet Atë Bardhi:

I botuar në "Zani i Shna Ndout", shkrimi mban titullin Shoqëria e "Bashkimit" e shoqëria e "Agimit". Në të, mes të tjerash, tregohen dallimet mes këtyre dy shoqërive, librat që u botuan me alfabetin e njëres dhe të tjetres. Sipas tij, ndasija mes tyre qëndronte në një pikë:

Pak mbrapa kundra shoqëritë të "Bashkimit" kje themelue shoqëria e "Agimit". Kundërshtimi i "Agimit" ishte të përdorimet e shkronjave me shejë në vend të shkronjave të dyzume, e kështu n'alfabet t'"Agimit" ishin nandë bazhkëzanore me shejë siprit.

Në vijim, kur flet për çështjen e Kongresit të Manastirit, Bardhi thotë:


...Për këtë arsye, atdhetarët e zgjedhun në komision, e panë me udhë që për gjuhën shqype t'u përdorojshin dy alfabetat: i Stambollës e i "Bashkimit" me ato ndryshime që përdorohen sot.

Dom Ndre Mjeda përmendet vetëm si përfaqësues i Agimit në Kongres, pa iu dhënë asnjë meritë e atillë sikurse është ajo që pretendon Ujka.

Për t'u rikthyer te shkrimi i Atë Bardhit në Hyllin e Dritës, në mbyllje ai thotë:

*Emzot Doçi e D. Ndre Miedia kan kënë dy burra e dy atdhetarë të ndershem e, ndonse kundërshtarë në çashtje t'alfabetit – të dy – gjithçili simbas pikpamjet të vet – kanë punue per të mirë t'atdheut. Por gjithçili ka meritimet e veta e nuk është nevoja me marrë lavdet e njënit e me ja mbështetë tjetrit. **Unicuique suum.***

...Kurrkush nuk mundet me e mohue se D. Ndre ka kënë një nder shkrimtarë e vjershtarë më të mirë që ka pasë Shqypnija. Pra i mjaftojnë lavdet e veta e s'ka nevojë për të huejat, të cilat, po t'ishite gjallë – si burrë me karakter që ka kënë – ai vetë nuk



kishte me i pëlqye.

Na të gjithë punojmë me një program: "Fe e Atdhe". Por çdo polemikë që bëhet sot mbi ket çashtje krejt të pavend e të panevojshme, veç dëm se kurrfarë dobie s'i bje as fesë e as atdheut.

Me sa duket, Ujka këtë shënim e ka marrë sikur i drejtohej atij, prandaj, sërish në Kumbona e së Diellës (vjeti 5, nr. 34, fq. 410 – 411) boton një shkrim, me po të njëjtin titull si i pari: Shënjime rreth alfabetit.

Një artikull i vogël i imi me të njajtin titull botue në "Kumbonen e së Diellës"... paska tërthjekë oroen e të nderit Atë Pashko Bardhit i cili, ndonëse tërthuer e pa më emnue, më ka nderue me një përgjegje nder fletët e "Hyllit të Dritës"...

Pasi citon çfarë Bardhi ka shkruar, vijon:

*Këto fjalë t'Atë Pashkos nuk kanë se si me i u shkrepë tjetër sendit, por njatij pohimit të paraqitun prej mejet n'artikull se: alfabeti i sodshëm është veper e D. Ndre Mjedës. Por, tue më bërë mue një padi kaq të randë, se kam shtrembnue të verteten historike, ishte lypë që Atë Pashkja të kishte ditue njikohësisht se kush kje, mbas tij, autori i alfabetit. Pse këtu nuk e kemi çashtjen se kush e mori iniciativën për të përbam alfabetin, as kujt i shkoi meritimi për përpjekjet e bame që lunnisht ja mbërriten qellimit të pranimit të tij, por të pyetunit që bëhet asht: **kush e hartoi alfabetin?***

Pasi shtron këtë pyetje, Ujka thotë se nuk mund të jetë "një komision" pse, sipas tij, veprimi njerëzor nuk mundet

*me pasë një kavi impersonale, **actiones sunt suppositorum.** Ai vazhdon t'i mëshojë idesë se është pikërisht Dom Ndre Mjeda hartuesi, tanimë duke dhënë një fakt i cili mund të mos jetë bindës, por është mjaft interesant:*

Por unë pohimin se hartuesi i alfabetit asht Dom Ndreu nuk e kam trillue prej vedit. Tue lënë në njanen anë çka kam mujtë me ndi edhe prej pjestarëve të tjerë të Kongresit, unë pohimin e treguem e kam ndi shi prej gojës së Dom Ndre Mjedës, i cili, në një rasë, formalisht ka deklarue se alfabetin e Manastirit e ka hartue ai rrokull punimeve të Kongresit, e se ky alfabet i paraqitun prej tij, kje pranue prej komisionit e prej Kongresit pa kurrnjë ndryshim. Sipas Gjon Ujkës, nuk ka qenë vetëm ai personi i cili e ka dëgjuar këtë deklaratë; kanë qenë edhe të tjerë, emrat e të cilëve nuk thuhet:

Ket deklaratë të Dom Ndreut e kanë ndi edhe të tjerë sikurse unë. Pra nuk asht rasti kur: i zoti e jep e tellalli s'e jep, por asht tellalli që bëhet jehona e fjalës së të zotit.

Duke u bazuar edhe në pohimin e Atë Bardhit për karakterin e Mjedës, Ujka vijon: Pohimi i bamë prej Dom Ndreut lypet të besohet pa tjetër, sepse, si e thekson edhe Atë Pashkja vetë, Dom Ndre Mjeda ka kënë një burrë i ndershem e me karakter, e përveç kësaj, ka kënë edhe një Meshtar katolik shembulluer në të cilin posë virtyteve tjera, ka spikatë ai i përvujtnisë, e pra kishte me kënë absurd me mendue se ai ka bërë një deklaratë të rrëshme tue i

mveshë vedit një meritim që s' do ta kishte.

Ujka e di se një deklaratë e tillë ngjan e pabesueshme pasi, sikurse thonin latinët, *verba volant, scripta manent*, ndaj shkrimi i tij vazhdon:

Mundet me këne se ndoshta nuk ka me u besue dëshmia e jëme prej Atë Pashkos ose kujtdo kjoftë. Ani çka. Detyra e jëme e e të tjerëve si unë, është gjithmonë me dhanë dëshminë ma të plotë e formale për çka kemi ndi prej Dom Ndreut.

Puna pse Dom Ndre Mjedja ket deklaratë nuk e ka bâ me të shkrueme sa kje gjallë, nuk provon kurrëgjia. Përveçse ai nuk ishte një reklamist i veprimtarive të veta, çashtja se kush asht këne hartuesi i alfabetit nuk asht çilë asnjë herë, e nuk asht gjetë kurrë kush që me i thanë Dom Ndreut: Alfabetin e kam hartue unë e jo ti. Prandej nuk ka këne nevoja me bâ një pohim që asht kenë i dijtun e i pranuem prej pjestarëve të Kongresit sa ishin gjallë. Vetem në një rast të posaçëm që asht paraqitë, e ka ba gojas deklaraten e naltregueme, tue theksue se po e thote jo për me i bâ një lavd vetvedit, por sa me u dijtë.

Pra, tanimë kemi një dëshmi të supozuar nga Dom Ndre Mjeda se ka qenë ai hartuesi i fjalorit. Duhet kuptuar qartë, jo ai që ka

krijuar shkronjat, pasi shkronjat e alfabetit të Agimit janë me shenja diakronike dhe jo dyshe, sikurse qe ai që u vendos nga Kongresi, por ai i cili ka "përzgjedhur" grafemat për t'iu përgjigjur fonemave të shqipes.

Në periodikët e asaj kohe, mund të lexoje shpesh për këtë temë. Por pse ajo ka hapur dhe vijon të hapë diskutime akoma dhe sot? Le të bëjmë një udhëtim të shkurtër kronologjik në ditët kur u mbajt Kongresi, duke u bazuar në raportin e bërë gjatë gjithë ditëve që ai zgjati, botuar në numrin special të revistës LEKA me rastin e XXV – vjetorit të pavarësisë, datë 28 nëntor 1937, fq. 350 – 363.

Si fillim flitet për dy ditët e para të Kongresit kur prezantohen delegatët dhe bëhet e qartë arsyeja përse ishin mbledhur. Secili jep mendimin e vet për çështjen e alfabetit, dikush duke kërkuar të përdorej ai i Stambollit, dikush i Agimit e dikush i Bashkimit. Ditën e tretë duket se merr udhë fundi i një moskuptimi dhe fillimi i punës serioze në këtë drejtim: Dit' e tretë

Manastiri këtë ditë u gdhi i bardhë prej dëborës. Kjo ish një shënjë që edhe delegatët do të dalin faqebardhë prej kongresit, dhe ky mejtim do

t'ish në të tërë delegatët se e pamë që të ftohtët dhe të lagëtis e kohës dimënore nuk ua pakësoj as fare dëshirënë e zjarrtë.

Delegatët përpara drekës u mblodhën në mbledhje të mbyllur dhe zunë të kuvendojnë për zgjedhjen e komisionit.

Sikundrë q' ishte shkruar dhe në program, delegatët të tërë do të zgjidhnin një komision në mes tyre, i cili do të kuvëndonte për të dhënë një funt çështjes së abecesë.

Pas shumë kuvendë, u vendos që të zgjidhet një komision fuqiplotë prej njëmbëdhjetë vetash; u vendos dhe që ky komision të zgjidhet me zë të fshehtë; vendimet (kararët) e komisionit do të marrin funt me shumë të zëravet, dhe delegatët të tërë janë të betuar që të bëjnë kabull ç'të vendosnjë komisioni.

Pas dreke nisi zgjedhja e komisionit.

Çdo klubi, shoqënie dhe qyteti j'u dhanë dy zëra; pra ata delegatë që kishin' ardhur me një shok, kishin secilido nga një zë; ata që kishin' ardhur vetëm nga dy zë dhe ata q'ishinë të dërguarë prej dy shoqërive kishin' nga katër zë.

Çdo delegati j'u dhan' aqë bileta sa zëra kishte, dhe u vendos që ay që të fitojë më tepër zë, do të jetë kryetar i

komisionit.

Na fryt i zgjedhjesë:

Bajram Topulli

Buda Dimitraq

Cilka Ligor

Fishta Gjergj

Midhat Frashëri

Mjeda Andrea

Nyzhet Vrioni

Peci Sotir

Qiriaz Gjergji

Shahin Kolonja

Me qenë se Zoti Fishta nga 52

zërë fitoj 49, u zgjodh për

kryetar. U vendos që komisioni

të mblidhet të nesërmen në

mëngjes...

Atë Fishta, pastaj me ate fuqi së

fjalës q'e ka vetiu, tha se sado

q'është' i dërguar prej shoqërisë

"Bashkim", s'ka ardhurë për të

mprojtur atë abece, po për të

gjeturë një mënyrë që të

bashkohemi të tërë...

Për tre ditët e ardhshme, thuhet

komisioni këto ditë punoj në

mbledhje të mbyllurë. Pikërisht

këto ditë nxitën diskutimin se

kush e hartoi alfabetin, duke

krijuar edhe debatin mes Gjon

Ujkës dhe Atë Pashko Bardhit

që ndërtoi këtë shkrim. Duhet

thënë se në asnjë moment,

pyetjes së shtruar që në titull

nuk synojmë t'i japim një

përgjigje shtruese, por të

parashtrijmë një çështje e cila

vijon të mbetet e pazgjidhur

përfundimisht, duke treguar të

dy anët e saj.

Më poshtë është vendimi përfundimtar i komisionit i cili vendosi të përdoshin dy alfabete nga të cilët mbijetoi i dyti, ai që akoma dhe sot përdoret për të shkruar gjuhën shqipe.

Pasi u prezantuan alfabetet nga Luigj Gurakuqi, Atë Fishta mori fjalën dhe, sikurse tregon raporti, *çkoqiti abecenë dhe tha se abece e Stambollit është' e mjaftë për nevojat e kombit, po, me qenë se shumë herë për të shtypur libra larg Shqipërisë dhe për të hequr telegraf kemi nevojë për një abece latine, komisioni u shtrëngua të marrë dy abece...*

Pas fjalës së tij, *gjindja rrëfeu gazë duke përpjekurë duartë dhe duke thirurë: Roft abecejat! Nëse shkrimtarët shqiptarë do të ishin një komb, kjo ditë*

mund të ishte festa e tyre

kombëtare. Gjuha shqipe, si

atdheu i tyre i përherëshëm, ia

del të kapërcejë çdo kufi

politik e shoqëror, duke i

marrë të gjithë në truallin e

vet, majë të cilit është ndërtuar

tempulli me faqet e secilit libër

që javën e kaluar u ofrua

nëpërmjet Panairit online.

Prandaj alfabeti është në

secilin skaj të tempullit të

letërsisë shqipe, vende –

vende prej xhami nga ku

përgjatë shekujve futej brenda

e vetmja dritë lirije.



Anëtarët e shoqërisë "Bashkimi"

Ekspozita 'Etërit e Pavarësisë' rikujtoi figurat e shquara të 28 Nëntorit



40 nënshkruesë të aktit të Pavarësisë së Shqipërisë erdhën nëpërmjet punimeve artistike të Arben Morinës në ekspozitën "Etërit e Pavarësisë" në Muzeun Historik Kombëtar, shkruan KultPlus.

Ekspozita e cila solli 40 figura të rëndësishme të historisë shqiptare nëpërmjet pikturave të piktorit Arben Morina, u shoqëruan me artefaktet e këtyre nënshkruesve në ekspozitën "Etërit e Pavarësisë". Në fjalën e tij përshëndetëse Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, u

shpreh se kjo ekspozitë është një kombinim i përkryer i portreteve në pikturë të etërve tanë të 40 firmëtarëve të pavarësisë dhe objekteve të tyre personale që ndodhen në Muzeun Historik Kombëtar. Tutje ai përmendi se të ekspozuara janë edhe një kopje të aktit të shpalljes së pavarësisë dhe disa objekte të Luigj Gurakuqit, Kristo Floqit, për të bërë të mundur këtë lloj harmonie në pasqyrimin e kësaj ekspozite në kombinim me veprat e prezantuara në pikturë të shumë të talentuarit Arben Morina.

Në anën tjetër, protagonisti kryesor i cili rikujtoi nëpërmjet artit rëndësinë e këtyre personaliteteve, Arben Morina falenderoi Muzeun Historik Kombëtar për këtë ekspozitë.

"Për mua kjo ekspozitë ka një rëndësi të veçantë dhe kam ndjerë gjithçka që kam bërë pasi vet gjyshi im Zihni Abas Kanina Hamzaraj ishte një nga nismëtarët e shpalljes së pavarësisë", tha artisti Morina. Ekspozita "Etërit e Pavarësisë" u organizua në kuadër të manifestimeve të nëntorit. / KultPlus



Ministrja e Kulturës për Blloshmin: Ti na folle me veprën tënde më shumë se mijëra fjalë



Për vdekjen e piktores Lumturi Blloshmi nga Covid-19 ka reaguar edhe ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Elva Margariti.

Nëpërmjet një postimi në facebook ministrja ka shkruar për veprimtarinë e bujshme të Blloshmit.

"Covid 19 na mori sot një tjetër emër të madh të artit shqiptar: Lumturi Blloshmin, ndër të paktat

artiste pamore të brezit të saj, që sfiduan kohën, sistemet politike, ndryshimet e mëdha", ka shkruar Elva Margariti

Tutje ka kujtuar momentet kur ishte ndalur para bustit të saj në Galerinë Kombëtare të Arteve

"Një portret i skalitur ashtu si ishte arti dhe qëndrimi i saj estetik", ka shkruar Margariti.

Për fund, ministrja ka vlerësuar se

Blloshmi ka folur me veprën e saj më shumë se me mijëra fjalë.

E krahasuar me Frida Kahlon, Lumturi Blloshmi mban mbi shpinë 25 vite krijimtari. Ajo njihet si piktorja që lëvroi ndër të parat performancën dhe instalacionin në vendin tonë. Vitet e fundit Lumturi Blloshmi u prezantua edhe me ekspozita në disa galeri private në Tiranë, Durrës, apo Korçë.

Ekspozita e Gazmend Lekës në FAB, reflektim për jetën



Në këto ditë të vështira që po kalon bota për shkak të pandemisë, artisti Gazmend Leka ka çelur ekspozitën "NOE" e cila vjen për publikun në këto momente delikate si shkëputje ndaj realitetit drejt artit.

Në ambientet e galerisë FAB pranë Universitetit të Arteve, kjo ekspozitë vjen për publikun si pjesë e trilogjisë pasi më parë janë hapur nga artisti edhe dy ekspozita te tjera me titujt " Lutja" dhe " Dhoma e Hapave të Humbur".

Kjo ishte edhe vetë ideja e artistit, që kjo ekspozitë të mbyllte ciklin e trilogjisë ku të 24 veprat e paraqitura këtë herë për publikun kishin në fokus aleancën e prishur tashmë mes njerëzve dhe krijuesit hyjnor.

Vetë artisti shprehet se kjo ekspozitë gjithashtu bërtet me zë të lartë dhe i bënë jehonë dramave të shqiptarëve dhe pse jo edhe qytetarëve të gjithë globit të cilët së fundmi kanë përjetuar shumë mallkime. Ai shprehet gjithashtu

se të gjithë ne në mënyrën tonë duhet të reflektojmë dhe të veprojmë sa nuk është vonë.

Vetëm duke u kthyer tek krijuesi dhe vlerave njerëzore të cilat gjithsecili nga ne ka, atëherë do të kemi mundësinë të rifillojmë nga e para dhe të respektojmë mbi të gjitha hapësirën e çdo specie që meriton vendin e vet në këtë botë. Ekspozita do të qëndrojë e hapur për publikun deri më 30 nëntor në galerinë FAB pranë Universitetit të Arteve. /atsh/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sot takohen Besa - Prishtina, nesër Gjilani - Drita

FC Prishtina po synon që të marrë tri pikët e plota në ndeshjen kundër Besës, e cila zhvillohet sot në Brestovik. Nesër (e diele) zhvillohet derbi i kësaj xhiro mes Gjilanit dhe Dritës

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Java e 15-të në Superligën e Kosovës në futboll nis sot (e shtunë) me ndeshjen mes rivaleve të vjetër Besës dhe Prishtinës. Kjo përballje e ka humbur interesimin që kishte dikur, pasi klubi pejanë për dy edicione kishte rënë në Ligën e Parë dhe përkundër rikthimit në Superligë nuk ka kualitetin e njëjtë me Prishtinën. Kryeqytetasit pas fitores në mesjavë kundër Llapit kërkojnë edhe tri pikët e reja nga kjo ndeshje. "Besa e këtij edicioni edhe pse po luan me përbërje me djem të ri, po paraqiten mjaft mirë dhe pothuajse çdo skuadër i kanë shënuar gol, pra ne duhet të jemi maksimalisht të kujdesshëm për të vazhduar me serinë pozitive të fitoreve që e kemi. Duam t'i marrim ndeshjet me radhë një pas një e që të afrohem sa më shumë kreut të klasifikimit drejt qëllimit që kemi", ka thënë Behar Maliqi, mesfushor i Prishtinës.

"Normalisht ekipi ka filluar të fitojë, kurse sa i përket meje unë jam i gatshëm në çdo moment të ndihmoj skuadrën sa herë që trajneri të më jep rastin apo të kërkoj nga unë që të jap kontributin tim. Për momentin jam mirë, si fizikisht si në të gjitha aspektet dhe në çdo moment jam i gatshëm të jap maksimumin në fushë", ka shtuar Maliqi. Të dielën zhvillohet derbi i kësaj xhiro në mes Gjilanit dhe Dritës, derbi i cili vlerësohet si më i madhi në futbollin e Kosovës. Drita ka gabuar në ndeshjen e fundit dhe tash synon t'i rikthehet fitoreve në ndeshjen ndaj rivaleve lokal,

SUPERLIGË

Të shtunën takohen:
13:00 Besa - Prishtina

Të dielën takohen:
13:30 Gjilani - Drita
13:00 Feronikeli - Trepça '89

Të hënën takohen:
13:00 Ballkani - Arbëria
13:00 Drenica - Llapi



por edhe Gjilani kërkon maksimumin e pikëve për të qenë në hap me skuadrat

kryesuese. Të dielën zhvillohet edhe ndeshja në mes Feronikelit dhe Trepçës '89, derisa të hënën

zhvillohen dy ndeshjet tjera ku takohen Ballkani-Arbëria dhe Drenica-Llapi.

Kosova sot përballet me Islandën



PRISHTINË, 27 NËNTOR - Përfaqësuesja Kosovës në basketboll të shtunën do të përballet me Islandën, në takimin që zhvillohet në Bratislavë nga ora 16:00. Ky takim zhvillohet në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Kosova dhe Islanda ishin ballafaquar edhe në Prishtinë, ku fitore kishin shënuar Dardanët me rezultat 80:78. Kosova hyn në këtë duel pas humbjes nga Sllovakia 91:67, derisa Islanda pas fitores ndaj Luksemburgut 90:76. Në Grupin B, Sllovakia, Islanda dhe Kosova kanë

grumbulluar nga pesë pikë, kurse Luksemburgu ndodhet e fundit me tri pikë. Edhe në ndeshjen e së shtunës, Dardanët do të kenë disa mungesa, megjithatë, përkundër vështirësive, basketbollistët e Kosovës premtajnë angazhim maksimal. Në ndeshjen tjetër të grupit, Sllovakia e pret Luksemburgun, që zhvillohet nga ora 19:00. Kosova ndeshjet e fundit në grup do t'i ketë në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, ku do të përballet me Sllovakinë dhe Luksemburgun.

Shqipëria ngritët në renditjen e FIFA-s, Kosova nuk ndryshon pozicion

TIRANË, 27 NËNTOR - Fitoret në dy ndeshjet nëntorit për Ligën e Kombeve i dhuruan Kombëtares së Shqipërisë vendin e parë në grup, por në të njëjtën kohë kanë pasur një impakt pozitiv edhe në

renditjen e përgjithshme të FIFA-s. Në përditësimin e klasifikimit botëror, skuadra kuqezi ka fituar tre pozicione duke u ngjitur në vendin e 66-të. Shqipëria mundi në fillim Kazakistanin dhe më pas

Bjellorusinë suksese këto janë pasqyruar edhe në renditjen e FIFA për muajin nëntor. Nuk ka ndryshime për pozicionin e Kosovës, që vazhdon të mbajë vendin e 117-të, pavarësisht se mbylli aventurën në Ligën e

Kombeve me fitoren 1-0 kundër Moldavisë. Nuk ndryshon për këtë muaj as kryesimi. Belgjika vazhdon të mbajë vendin e parë, e ndjekur nga Franca dhe Brazili.



Kosova në vazon e pestë për kualifikimet e Botërorit 2022

CYRIH, 27 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është në vazon e pestë për shortin e kualifikimeve për Kampionatin Botëror "Katari 2022". Shtëpia botërore e futbollit - FIFA, të premten, ka publikuar ndarjen e përfaqësueseve evropiane

nëpër vazo, për shortin që do të tërhiqet më 7 dhjetor në Zuerich. Ndarja e përfaqësueseve nëpër vazo është bërë duke u bazuar në renditjen e tyre në ranglistën e FIFA-s. Krahas Kosovës, në vazon e pestë janë edhe Armenia, Qipro, Ishujt Faroe,

Azerbajxhani, Estonia, Kazakistani, Lituania, Letonia e Andorra. Ndërkohë, Shqipëria është në vazon e katërt dhe ekziston mundësia që të jetë në një grup me Kosovën, për herë të parë. Më herët këtë muaj, Kosova e mbylli edicionin e dytë të Ligës së Kombeve, ku

përfundoi e treta në grupin e tretë të Ligës C. Shqipëria doli e para në grupin e katërt të Ligës C dhe në edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve do të luajë në Ligën B, që është niveli i dytë. Kualifikimet për Botëror fillojnë në mars të vitit të ardhshëm.



Legjenda Maradona përcillet në banesën e fundit



BUENOS AIRES, 27 NËNTOR - Diego Armando Maradona është përcjellë për në banesën e fundit nga anëtarët e familjes dhe miqtë e ngushtë, të cilët ishin të vetmit që u lejuan në varrezat Jardín bella Vista në Buenos Aires. Ai është varrosur pranë prindërve të tij, Dalma dhe Diego, ndërkohë që rrugët sot ishin pushtuar sërish nga tifozët.

Makina që transportonte trupin e Maradonës kaloi në masa të rrepta sigurie, ndërkohë që shumë njerëz tentonin ta preknin sa herë ndalte prej trafikut. Deri ditën e djeshme, në orën 18:00, për 12 orë njerëzit kishin mundësinë të bënin nderimet e fundit në pallatin presidencial, ndërkohë që nuk munguan edhe trazirat që

sollën edhe arrestime e njerëz të plagosur. Edhe pse një ceremoni mortore, tifozët kishin mbushur rrugët me flamuj kombëtar dhe kënduan për idhullin e tyre. "Diego nuk ka vdekur, Diego jeton te njerëzit", ishte një nga koret e shumta që dëgjohej, ndërkohë që tifozët një ditë më parë kishin hipur në kangjellat e pallatit presidencial.

Maradona ishte i pari që më telefoni kur u pensionova

ROMË, 27 NËNTOR - Vdekja e Diego Armando Maradonës vazhdon të jetë tema kryesore në botën e futbollit. Largimi nga kjo botë i gjenit të topit, ka krijuar trishtim dhe mërzitje të madhe te të gjithë. Francesco Totti kishte një raport fantastik me legjendë argentinase. Ish-kapiteni i Romës flet rreth Maradonës në një deklaratë për Canale 5, duke zbuluar edhe një detaj interesant. "Diego është akoma këtu me ne. Emocionet që na ka dhuruar janë të papërsëritshme. Ne kishim një marrëdhënie të mrekullueshme, ai ishte një person i jashtëzakonshëm jashtë fushave, ndërsa në fushë ishte vetë futbollit, i paimitueshëm. As në playstation nuk mund të kopjohet ajo çfarë bënte Diego. Dua ta mbaj mend sikur nuk ka vdekur kurrë. Kur lashë futbollin, ai ishte personi i parë



që më telefoni. Më dha mbështetjen e tij dhe më tha të qëndroja i qetë. Nuk do e harroj kurrë atë gjest që kreu. Nëse do

të organizohet një ndeshje në nderim të tij dhe do të më ftonin, do të pranoja me kënaqësi", ka deklaruar Totti.

SHKURT

Bie vlera e Rashicës

Vlera e yllit të Kosovës, Milot Rashica në dhjetor të vitit 2019 kishte arritur në 35 milionë euro nga "Transfermarkt", pasi edhe lojtari nga Kosova po shkëlqente me gola e asistime. Kjo vlerë që nga dhjetori i vitit të kaluar ka vazhduar duke rënë, teksa fillimisht ishte 28 milionë euro e pastaj në 22 milionë. Faqja e specializuar për vlerën e futbollistëve ka bërë përditësimet e reja, ku vlera e Rashicës ka rënë edhe më shumë. 24-vjeçari tani nga kjo faqe vlerësohet vetëm 18 milionë euro. Interesim për lojtarin nga Vushtrria kanë shfaqur Bayer Leverkusen, Wolfsburg, Leeds United dhe RB Leipzig.

Shtyhet shorti i 1/16 së finales së Kupës në futboll

Shorti për 1/16 e finales së Kupës së Kosovës në futboll i paraparë për t'u tërhequr sot është shtyrë. Kjo për shkak se në bazë të rregullores së re të garave nga ky rreth shorti duhet të jetë gjysmë i dirigjuar, ku në njërin vazo futen 16 ekipe (10 të Superligës dhe 3 ekipet e para nga secili grup i Ligës së Parë pas përfundimit të stinorit vjeshtor) dhe në vazon tjetër 16 ekipet e tjera (14 ekipet e Ligës së Parë nga pozita 4 deri në pozitën 10 nga secili grup pas përfundimit të stinorit vjeshtor) dhe dy ekipet e kualifikuara nga tri rrethet e para nga Liga e Dytë dhe Liga e Tretë. Duke pasur parasysh se garat e Ligës së Parë të stinorit vjeshtor nuk kanë përfunduar ende dhe renditja tabelore mund të ndryshojë në dy javët e fundit, atëherë Komisioni i Garave në mënyrë që të mos ketë konsekuenca, me mirëkuptimin e përfaqësuesve të klubeve, e vlerësoi të arsyeshme që tërheqja e shortit të rrethit të 1/16 së finales së Kupës së Kosovës të shtyhet dhe të bëhet menjëherë pas përfundimit të stinorit vjeshtor në Ligën e Parë.

Ibra takohet me Andersonin

Trajneri i Suedisë, Jane Anderson është i gatshëm të vazhdojë të bisedojë me veteranin Zlatan Ibrahimović për të vendosur për rikthimin e sulmuesit të kombëtarja e Suedisë, katër vite pas tërheqjes nga përfaqësuesja nordike. Të dy janë takuar së fundmi me njëri-tjetrin rreth mundësisë që 39-vjeçari i Milanit të rikthehet te Suedia. Pas përfundimit të takimit, Anderson tregoi se ndihet i lumtur për gatishmërinë e Ibrës për të kontribuar sërish në kombëtaren suedeze. Ai shtoi se do të vazhdojë të diskutojë me sulmuesin për zgjidhjen e çështjes. "Kur Zlatan Ibrahimović hapi sërish temën e kthimit në kombëtare, ndihet natyrshme dhe rëndësishme që të takoheshim e të bisedonim sa më shpejt të jetë e mundur. Jam i kënaqur që mundëm të takoheshim kaq shpejt. Takimi shkoi shumë mirë dhe vendosëm të vazhdojmë të dialogojmë", ka deklaruar Anderson. Duket se 58-vjeçari ka ndryshuar qëndrim në kurs 180 gradë, teksa e quante "mbyllur derën për Ibrahimovićin te Suedia".

Tenistja bullgare kurdisi ndeshjet e saj, përjashtohet përjetësisht nga tenisi

Tenistja bullgare Aleksandrina Naydenova është përjashtuar përgjithnjë nga sporti, pasi është konsideruar fajtoare në kurdisjen e ndeshjeve të saj. Tennis Integrity Unit (TIU) e ka konsideruar tenisten 28-vjeçare bashkëpunëtore në manipulimin e rezultatit të disa ndeshjeve. Renditja e saj më e mirë në sport ka qenë vendi 218, ndërkohë që pezullimi daton që nga dhjetori i vitit të kaluar, kur u akuzua zyrtarisht dhe u pezullua përkohësisht, në pritje të vendimit. Sipas TIU, tenistja Naydenova ka manipuluar të paktën 13 ndeshje të saj, mes viteve 2013-2019, një numër i konsideruar i lartë.

LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumëfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirimin kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhështi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË
(1990-1991)




“A po shkruan Barney?”
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.
 “A po të shiten librat?”
 “Po marrë çeqe nga të drejtat e autorit”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”
 “Për femrat moderne”.
 “Për femrat moderne?!”
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrësisht të këqija”.
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkiten dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €



Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI
EMANCIPIMI I GRUAS

Përktheu: Fadil Bajraj





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.3718/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Valmir Xhigoli nga Fushë Kosova, me adresë në rr. "Azem Sogojeva", nr.2, të cilin e përfaqëson me prokurë Sadije Mjekiqi, avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Claudia Anna Bayer Hassman nga Gjermania, tani me adresë të panjohur, për zgjidhje të martesës me shkurorëzim, duke vendosur lidhur me propozimin e paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, jashtë seancës gjyqësore, me datën 13.11.2020 mori këtë:

AKTVENDIM

I- Të paditurës Claudia Anna Bayer Hassman nga Gjermania, tani me adresë të panjohur, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Blerina Restelica, avokate në Prishtinë, e cila ka për obligim që të paditurën ta përfaqësojë në procedurën për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim në lëndën C.nr.3718/19.

II- Sipas Dispozitës së nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se iu ka caktuar kujdestari.

III- Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në Tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësi, përmes përfaqësueses së tij, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me dt. 30.10.2019, kundër të paditurës Claudia Anna Bayer Hassman nga Gjermania, tani me adresë të panjohur, për zgjidhje të martesës me shkurorëzim.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore më datë 09.10.2020, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesja me prokurë Sadije Mjekiqi, ndërsa për të paditurën nuk ka prezantuar askush në seancë. Me qëllim që çështja të mos zvarritet nga ana e të paditurës, i propozoi gjykatës që të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm sipas dispozitës së nenit 79.3 të LPK-së, për të paditurën Claudia Anna Bayer Hassman nga Gjermania, tani me adresë të panjohur.


Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79, paragrafi 3, pika a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën. Andaj, gjykata vendosi që të paditurës t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Blerina Restelica, avokate në Prishtinë, nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, e cila do ta përfaqësojë interesin e të paditurës në këtë çështje juridiko-civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C. nr. 3718/19, datë 13.11.2020

Gjyqtarja
Shpresa Veselaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.Z. "Gedore" me seli në Prishtinë, me numër të biznesit: 71157342, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 601251549

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

